

32003L0071

Direktivë 2003/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, date 4 Nëntor 2003, “Për prospektin që do të publikohet kur titujt i ofrohen publikut ose pranohen për t'u tregtuar dhe që ndryshon Direktivën 2001/34/KE”

(Tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në)

Gazeta Zyrtare L 345, 31.12.2003 F. 0064 - 0089

Direktivë 2003/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 4 Nëntor 2003, “Për prospektin që do të publikohet kur titujt i ofrohen publikut ose pranohen për t'u tregtuar dhe që ndryshon Direktivën 2001/34/KE”

(Tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në)

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Evropian dhe, në veçanti, Nenet 44 dhe 95 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit ⁽¹⁾,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social ⁽²⁾,

Duke pasur parasysh opinionin e Bankës Qendrore Evropiane ⁽³⁾,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e parashikuar në Nenin 251 të Traktatit ⁽⁴⁾,

Meqë:

1. Direktiva e Këshillit 80/390/KEE e 17 Marsit 1980 që koordinon kërkesat për hartimin, shqyrtimin dhe shpërndarjen e të dhënave të listimit që publikohet për pranimin e titujve në bursë ⁽⁵⁾ dhe 89/298/KEE e 17 prillit 1989, që koordinon kërkesat për hartimin, shqyrtimin dhe shpërndarjen e prospektit që publikohet kur titujt e transferueshëm i ofrohen publikut ⁽⁶⁾, u miratuan disa vite më parë duke përdorur një mekanizëm njohjeje të përbashkët, të pjesshëm dhe kompleks, i cili nuk është në gjendje të arrijë objektivin e pasaportës së vetme të parashikuar nga kjo direktivë. Ato direktiva duhet të përmirësohen, të përditësohen dhe të grupohen në një tekst të vetëm.

2. Ndërkohë, Direktiva 80/390/KEE u integrua në Direktivën 2001/34/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 28 Majit 2001 për pranimin e titujve në bursë dhe për informacionin që do të publikohet për ato tituj ⁽⁷⁾, çka kodifikon disa direktiva në fushën e titujve të listuar.

3. Për arsye konsistence, gjithsesi, duhet të rigrupohen dispozitat e Direktivës 2001/34/KE që rrjedhin nga Direktiva 80/390/KEE bashkë me Direktivën 89/298/KEE dhe përkatësisht për ndryshimin e Direktivës 2001/34/KE.

4. Kjo Direktivë përbën një instrument thelbësor në arritjen e tregut të brendshëm, siç është përcaktuar në grafikun kohor në komunikatat e Komisionit "Plani i veprimit për riskun e kapitalit" dhe "Zbatimi i kuadrit për tregun financiar: Plani i Veprimit" lehtëson aksesimin më të gjerë të mundshëm në kapitalin investues në të gjithë komunitetin, duke përfshirë edhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME-të) dhe bizneset e reja, duke i dhënë emetuesit një pasaportë të vetme.

5. Më 17 Korrik 2000, Këshilli ngriti Komitetin e të Urtëve për rregullimin e tregjeve evropiane të titujve. Në raportin e tij fillestar të 9 Nëntorit 2000, Komiteti thekson mungesën e një përkufizimi, të rënë dakord, të ofertës publike të titujve, si rezultat i të cilës i njëjti funksion konsiderohet si ndërmarrje private në disa shtete anëtare dhe në disa të tjera jo; sistemi aktual dekurajon firmat që të rrisin kapitalin në nivel të gjerë komuniteti dhe rrjedhimisht për të pasur akses real në një treg financiar të madh, me likuiditet dhe të integruar.

6. Në raportin përfundimtar të 15 Shkurtit 2001, Komiteti i të Urtëve propozoi prezantimin e disa teknikave të reja legjislative bazuar në një qasje me katër nivele, konkretisht parimet kuadër, masat zbatuese, bashkëpunimi dhe zbatimi. Niveli 1, direktiva duhet ta përkufizojë gjerësisht veten në parimet e përgjithshme "kuadër", ndërsa Niveli 2 duhet të përmbajë masa teknike zbatuese për t'u miratuar nga Komisioni me ndihmën e një komiteti.

7. Këshilli Evropian i Stokholmit i 23 dhe 24 Marsit 2001 miratoi raportin përfundimtar të Komitetit të të Urtëve dhe qasjen e propozuar me katër nivele, për ta bërë më efikas dhe transparent procesin rregullues për legjislacionin komunitar për titujt.

8. Rezoluta e Parlamentit Evropian e 5 Shkurtit 2002 mbi zbatimin e legjislacionit të shërbimeve financiare miratoi edhe raportin përfundimtar të Komitetit të të Urtëve, në bazë të deklaratës solemne të mbajtur para Parlamentit në po atë datë nga Komisioni, si dhe të shkresës së 2 Tetorit 2001 që Komisioneri i Tregut të Brendshëm i drejtonte Kryetarit të Komitetit Parlamentar për Çështjet Ekonomike dhe Monetare në lidhje me garancitë për rolin e Parlamentit Evropian në këtë proces.

9. Sipas Këshillit Evropian të Stokholmit, masat zbatuese të Nivelit 2 duhet të përdoren më shpesh për të siguruar që dispozitat teknike të mbahen të përditësuara me tregun dhe me zhvillimet mbikëqyrëse dhe që të vendosen afate kohore për të gjitha fazat e Nivelit 2.

10. Qëllimi i kësaj direktive dhe i masave të saj zbatuese është të sigurojë mbrojtjen e investitorëve dhe efikasitetin e tregut, në përputhje me standardet e larta rregullatore të miratuara në forumet përkatëse ndërkombëtare.

11. Titujt pa kapital të emetuar nga një shtet anëtar ose nga një autoritet rajonal ose vendor i një shteti anëtar, nga organe publike ndërkombëtare ku bëjnë pjesë një ose më shumë shtete anëtare, nga Banka Qendrore Evropiane ose nga bankat qendrore të shteteve anëtare, nuk mbulohen nga kjo direktivë dhe rrjedhimisht mbeten të pandikuara nga kjo direktivë; emetuesit e lartpërmendur të titujve të tillë, munden gjithsesi, që me zgjedhjen e tyre të hartojnë një prospekt në përputhje me këtë direktivë.

12. Për të garantuar mbrojtjen e investitorëve nevojitet mbulimi i plotë edhe i titujve të tjerë që i ofrohen publikut apo që pranohen për t'u tregtuar në tregje të rregulluara, sipas përkufizimit në Direktivën e Këshillit 93/22/KEE të 10 Majit 1993 për shërbimet e investimit në fushën e titujve ⁽⁸⁾, dhe jo vetëm i titujve të pranuar në bursë. Përkufizimi i gjerë i titujve në këtë direktivë, i cili përfshin garanci dhe certifikata mbulimi, është i vlefshëm vetëm për këtë direktivë dhe rrjedhimisht nuk ndikon kurrësi përkufizimet e ndryshme të instrumenteve financiarë të përdorur në legjislacionin e brendshëm për qëllime të tjera, si p.sh tatimet. Disa nga titujt e përkufizuar në këtë direktivë i japin të

drejtë mbajtësit të blejë tituj të transferueshëm apo të marrë një sasi parash në dorë me anë të një transferte të përcaktuar duke iu referuar instrumenteve të tjerë, kryesisht tituj të transferueshëm, valutë, norma interesi apo produktiviteti, mallra për përdorim të gjerë apo tregues ose masa të tjera. Faturat e depozitarit dhe shënimet e konvertueshme, p.sh. titujt e konvertueshëm sipas zgjedhjes së investitorit, përfshihen në përkufizimin që bëhet për tituj të tjerë në këtë direktivë.

13. Emetimi i titujve të një lloji dhe/ose klase të ngjashme në rastin e titujve të tjerë të emetuar në bazë të një programi ofrues, duke përfshirë garanci dhe certifikata të çdo forme, si dhe në rastin e titujve të emetuar në mënyrë të vazhdueshme ose të përsëritur, duhet të kuptohet se mbulon jo vetëm titujt identik, por edhe titujt që përgjithësisht i përkasin një kategorie. Këto tituj mund të përfshijnë produkte të ndryshme, si p.sh tituj borxhi, certifikata dhe garanci, apo të njëjtin produkt sipas të njëjtit program dhe mund të kenë tipare të ndryshme kryesisht për sa i përket eksperiencës, llojit të themelimit, apo bazave mbi të cilat përcaktohet shumica e shlyerjes apo pagesa e kuponëve.

14. Dhënia e një pasaporte të vetme emetuesit, e cila është e vlefshme në të gjithë Komunitetin dhe zbatimi i parimit të vendit të origjinës kërkojnë identifikimin e shtetit anëtar të origjinës si vendin më të mirë për të rregulluar emetuesin për qëllimet e kësaj Direktive.

15. Kërkesat për nxjerrje informacioni të parashikuara në këtë direktivë nuk i ndalojnë shtetet anëtare, autoritetet kompetente apo bursën që të vendosin kërkesa të tjera të veçanta në rregulloret e tyre, sa i përket pranimit të titujve për t'u tregtuar në një treg të rregulluar (kryesisht lidhur me qeverisjen e korporatave). Kërkesa të tilla mund të mos kufizojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi hartimin, përmbajtjen dhe shpërndarjen e një prospekti të miratuar nga një autoritet kompetent.

16. Një nga objektivat e kësaj Direktive është të mbrojtë investitorët. Rrjedhimisht, duhet të merren parasysh kërkesat e ndryshme të mbrojtjes së kategorive të ndryshme të investitorëve dhe niveli i tyre i ekspertizës. Nuk është e nevojshme që të jepet informacion në prospekt për oferta të kufizuara vetëm për investitorët e kualifikuar. Nga ana tjetër, çdo rishitje për publikun apo ofertë publike me anë të pranimit për tregtim në një treg të rregulluar kërkon publikimin e një prospekti.

17. Emetuesit, ofruesit apo personat që kërkojnë pranim, për t'u tregtuar në një treg të rregulluar, të titujve që janë të përjashtuar nga detyrimi për të publikuar një prospekt, do të përfitojnë nga pasaporta e vetme, nëse janë në pajtim me këtë direktivë.

18. Dhënia e informacionit të plotë në lidhje me titujt dhe emetuesit e tyre, krahas normave të etikës së biznesit, ndihmon mbrojtjen e investitorëve. Për më tepër, ky informacion shërben si mjet efikas për rritjen e besimit të titujt, duke kontribuar në këtë mënyrë në funksionimin dhe zhvillimin e duhur të tregjeve të titujve. Mënyra e duhur për ta vënë në dispozicion këtë informacion është publikimi i një prospekti.

19. Investimet në tituj, ashtu si çdo formë tjetër investimi, kanë risk. Në të gjithë shtetet anëtare kërkohen garanci për mbrojtjen e interesave të investitorëve aktual dhe potencial, në mënyrë që ata të mund të bëjnë një vlerësim objektiv të këtyre risqeve dhe të marrin vendime për investime, duke qenë plotësisht në dijeni të fakteve.

20. Ky informacion, i cili duhet të jetë i plotë dhe sa më objektiv, për gjendjen financiare të emetuesit dhe të drejtat që mbartin titujt, duhet të jepet në një formë lehtësisht të analizueshme dhe të kuptueshme. Harmonizimi i informacionit që përmban prospekti duhet të sigurojë mbrojtje të barasvlershme për investitorët në nivel komuniteti.

21. Informacioni është një faktor kyç për mbrojtjen e investitorit; prospekti duhet të përmbajë një përmbledhje të karakteristikave thelbësore dhe risqeve të lidhura me emetuesin, çdo dorëzanës dhe me titujt. Për të garantuar aksesimin lehtësisht të këtij informacion, përmbledhja duhet të shkruhet në gjuhë jo-teknike dhe normalisht nuk duhet të jetë më shumë se 2500 fjalë në gjuhën që prospekti është hartuar fillimisht.

22. Janë miratuar praktikat më të mira në nivel ndërkombëtar për të lejuar që ofertat ndërkufitare të kapitalit të bëhen duke përdorur një grup të vetëm standardesh për nxjerrjen e informacionit, të vendosur nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO); standardet e nxjerrjes së informacionit të IOSCO ⁽⁹⁾ do të përmirësojnë informacionin që vihet në dispozicion të tregjeve dhe investitorëve dhe në të njëjtën kohë do të thjeshtojnë procedurën për emetuesit e komunitetit që dëshirojnë të krijojnë kapital në vende të treta. Direktiva bën thirrje gjithashtu për miratimin e standardeve të nxjerrjes së informacionit, të përshtatura për lloje të tjera titujsh dhe emetuesish.

23. Procedurat e gjurmimit të shpejtë për emetuesit e pranuar për të tregtuar në një treg të rregulluar dhe që rrisin shpesh kapitalin në këto tregje kërkojnë prezantimin e një formati të ri të prospekteve në nivel komuniteti, për të ofruar programe ose obligacione hipotekare dhe një sistem të ri regjistrimi të dokumenteve. Emetuesit mund të zgjedhin të mos i përdorin këto formate dhe rrjedhimisht të hartojnë prospektin si një dokument të vetëm.

24. Përmbajtja e një prospekti bazë duhet të marrë veçanërisht në konsideratë nevojën për fleksibilitet për informacionin që jepet rreth titujve.

25. Mospërfshirja e informacioneve delikate në prospekt, duhet të lejohet me anë të një derogimi të dhënë nga autoriteti kompetent në rrethana të caktuara, për të shmangur kështu situata të dëmshme për një emetues.

26. Duhet të vendoset një afat i qartë kohor për vlefshmërinë e prospektit për të shmangur informacionin e vjetëruar.

27. Publikimi i informacionit të besueshëm siguron mbrojtje për investitorët. Emetuesit, titujt e të cilëve janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, i nënshtrohen detyrimit të vazhdueshëm për shpalljen e informacionit por atyre nuk u kërkohet të publikojnë rregullisht informacion të përditësuar. Përveç këtij detyrimi, emetuesit duhet që të paktën një herë në vit, të listojnë të gjithë informacionin përkatës të publikuar apo që është vënë në dispozicion të publikut gjatë 12 muajve pararendës, duke përfshirë informacionin e dhënë sipas kërkesave të ndryshme të raportimit të parashikuara në legjislacione të tjera komunitare. Kjo do të garantonte publikimin e rregullt të informacioneve konsistente dhe lehtësisht të kuptueshme. Për të shmangur ngarkesa të tepërta për disa emetues, emetuesve të titujve të tjerë dhe që emetohen në monedha me prerje të mëdha minimale, nuk u kërkohet të përmbushin këtë detyrim.

28. Është e nevojshme që informacioni vjetor që jepet nga emetuesit, titujt e të cilëve janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, të monitorohet siç duhet nga shtetet anëtare, në përputhje me detyrimet e tyre, sipas dispozitave të legjislacionit komunitar dhe atij të brendshëm që rregullon titujt, emetuesit e titujve dhe tregjet e titujve.

29. Mundësia që emetuesit të lejohen të përfshijnë referime në dokumente që përmbajnë informacione që duhet të jepen në një prospekt - me kusht që dokumentet e referuara të jenë depozituar më parë

pranë autoritetit kompetent ose të jenë pranuar prej tij - do të lehtësonte procedurën e hartimit të një prospekti dhe do të ulte kostot për emetuesit, pa rrezikuar mbrojtjen e investitorëve.

30. Dallimet në lidhje me efikasitetin, metodat dhe kohën e verifikimit të informacionit të dhënë në një prospekt jo vetëm që e bëjnë më të vështirë që ndërmarrjet të rrisin kapitalin apo të pranohen për të tregtuar në një treg të rregulluar në më shumë se një shtet anëtar, por edhe pengojnë blerjen e tyre nga investitorët e vendosur në një shtet anëtar të titujve të ofruar nga një emetues i vendosur në një tjetër shtet anëtar ose të pranuar për tregtim në një tjetër shtet anëtar. Këto dallime duhet të eliminohen duke harmonizuar rregullat dhe rregulloret në mënyrë që të arrihet një shkallë e përshtatshme njëvlershmërie e masave mbrojtëse që kërkohen në secilin shtet anëtar për të garantuar dhënien e informacionit të plotë dhe sa më objektiv për mbajtësit aktual ose potencial të titujve.

31. Për të lehtësuar qarkullimin e dokumenteve të ndryshme që përbëjnë prospektin, duhet të inkurajohet përdorimi i komunikimit me anë të mjeteve elektronike të tilla si interneti. Për investitorët që e kërkojnë, prospekti duhet të dërgohet gjithmonë me shkresë dhe pa pagesë.

32. Prospekti duhet të dorëzohet në autoritetin kompetent përkatës dhe të vihet në dispozicion të publikut nga emetuesi, ofertuesi ose personi që kërkon pranim për tregtim në një treg të rregulluar, në varësi të dispozitave të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të dhënave.

33. Gjithashtu duhet të harmonizohen reklamata, për të shmangur boshllëqet në legjislacionin e komunitetit çka do të cenonte besimin e publikut dhe rrjedhimisht edhe funksionimin e duhur të tregjeve financiare.

34. Çdo çështje e re që ndikon në vlerësimin e investimeve, që lind pas publikimit të prospektit por para mbylljes së ofertës ose në fillim të tregtimit në një treg të rregulluar, duhet të vlerësohet si duhet nga investitorët dhe rrjedhimisht kërkon miratimin dhe shpërndarjen e një Shtojce në prospekt.

35. Detyrimi i emetuesit për të përkthyer prospektin e plotë në të gjitha gjuhët përkatëse zyrtare prapëson ofertat ndërkufitare apo tregtitë e shumëfishta. Për të lehtësuar ofertat ndërkufitare ku prospekti është hartuar në një gjuhë të zakonshme në sferën e financave ndërkombëtare, shteti anëtar pritës ose ai i origjinës ka të drejtë të kërkojë vetëm një përmbledhje në gjuhën/gjuhët e tij zyrtare.

36. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar pritës ka të drejtë të marrë një vërtetim nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës, i cili citon se prospekti është hartuar në përputhje me këtë direktivë. Për t'u siguruar që qëllimet e kësaj direktive do të përmbushen plotësisht, është gjithashtu e nevojshme që në objektin e tij të përfshihen titujt e emetuar nga emetuesit që rregullohen nga ligjet e vendeve të treta.

37. Shumëllojshmëria e autoriteteve kompetente në shtetet anëtare, që kanë përgjegjësi të ndryshme, mund të krijojë kosto të panevojshme dhe mbivendosje të përgjegjësive, pa ofruar ndonjë përfitim shtesë. Në çdo shtet anëtar duhet të caktohet një autoritet i vetëm kompetent për të miratuar prospektet dhe për të marrë përsipër përgjegjësinë e mbikëqyrjes së pajtueshmërisë me këtë direktivë. Nën kushte të rrepta, një shtet anëtar do t'i lejohet të caktojë më shumë se një autoritet kompetent, por vetëm një prej tyre merr përsipër detyrat për bashkëpunim ndërkombëtar. Ky autoritet ose autoritete duhet të themelohen si një organ administrativ në një formë të tillë që pavarësia e tyre të garantohet nga aktorët ekonomikë dhe të shmangen konfliktet e interesit. Përcaktimi i një autoriteti kompetent për miratimin e prospektit nuk duhet të përjashtojë bashkëpunimin mes atij autoriteti dhe subjekteve të tjera, me qëllim garantimin e shqyrtimit dhe miratimit efikas të prospekteve në interes të emetuesit, investitorëve, pjesëmarrësve në tregje dhe tregjeve të tjera të ngjashme. Duhet të rishikohet çdo

delegimin i detyrave që lidhen me detyrimet e parashikuara në këtë direktivë dhe me masat për zbatimin e tyre, në përputhje me nenin 31, pesë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj direktive dhe, përveç publikimit në internet të prospekteve të miratuara dhe depozitimit të prospekteve sipas nenit 14, duhet të përfundojë tetë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj direktive.

38. Një grup i përbashkët minimal kompetencash për autoritetet kompetente do të garantojë efikasitetin e mbikëqyrjes së tyre. Duhet të sigurohet rrjedha e informacionit në tregje, siç kërkohet nga Direktiva 2001/34/KE dhe autoritetet kompetente duhet të marrin masa kundër shkeljeve.

39. Me qëllim kryerjen e detyrave të tyre, është i nevojshëm bashkëpunimi mes autoriteteve kompetente të shteteve anëtare.

40. Për të pasur në konsideratë zhvillimet e reja në tregjet financiare, herë pas here mund të lindë nevoja për udhëzime teknike dhe masa zbatuese për normat e parashikuara në këtë direktivë. Për dispozita të tilla, Komisioni duhet të jetë i autorizuar të miratojë masa zbatuese, me kusht që këto masa të mos modifikojnë elementet thelbësore të kësaj direktive dhe që Komisioni të veprojë në përputhje me parimet e parashikuara në këtë direktivë, pasi të jetë këshilluar me Komitetin Evropian për Titujt të krijuar me Vendimin e Komisionit nr. 2001/528/KE ⁽¹⁰⁾.

41. Për ushtrimin e kompetencave zbatuese në përputhje me këtë direktivë, Komisioni duhet të respektojë parimet e mëposhtme:

- nevoja për të fituar besimin e investitorëve të vegjël dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME-ve) në tregjet financiare, duke promovuar standarde të larta transparence në tregjet financiare,
- nevoja për t'u mundësuar investitorëve një gamë të gjerë mundësish konkurruese për investime dhe një nivel zbulimi dhe mbrojtjeje të informacionit në përshtatje me rrethanat e tyre,
- nevoja për t'u siguruar se autoritetet e pavarura rregullatore zbatojnë vazhdimisht rregullat, veçanërisht në lidhje me luftën kundër krimit të jakave të bardha,
- nevoja për një nivel të lartë transparence dhe këshillimi me të gjithë pjesëmarrësit në treg dhe me Parlamentin dhe Këshillin Evropian,
- nevoja për të nxitur risitë në tregjet financiare, nëse ato do të jenë dinamike dhe efikase,
- nevoja për të siguruar qëndrueshmëri sistematike të sistemeve financiare me anë të monitorimit të ngushtë dhe reaktiv të risive financiare,
- rëndësia e uljes së kostos dhe rritjes së aksesit në kapital,
- nevoja për të balancuar, për një periudhë afat-gjatë, kostot dhe përfitimet nga çdo masë zbatuese për pjesëmarrësit në treg (duke përfshirë SME-të dhe investitorët e vegjël),
- nevoja për të nxitur konkurrencën ndërkombëtare të tregjeve financiare të Komunitetit pa cenuar rritjen aq të nevojshme të bashkëpunimit ndërkombëtar,
- nevoja për të arritur kushte të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit në treg, duke zbatuar legjislacionin komunitar, sa herë që duhet,

- nevoja për të respektuar dallimet në tregjet financiare kombëtare kur ato nuk shkelin padrejtësisht koherencën e tregut të vetëm,

- nevoja për të siguruar koherencë me ligje të tjera komunitare në këtë fushë, meqenëse pabarazitë në informim dhe mungesa e transparencës mund të rrezikojnë funksionimin e tregjeve dhe mbi të gjitha të dëmtojnë konsumatorët dhe investitorët e vegjël.

42. Parlamentit Evropian duhet t'i jepet një periudhë prej tre muajsh kohë nga prezantimi i parë i projektligjit për masat zbatuese, që të mund t'i shqyrtojë ato dhe të japë mendimin e tij. Megjithatë, në raste urgjente dhe të justifikuara, kjo periudhë mund të shkurtrohet. Nëse brenda kësaj periudhe miratohet ndonjë rezolutë nga Parlamenti Evropian, Komisioni duhet të ri-shqyrtojë projekt masat.

43. Shtetet anëtare duhet të vendosin një sistem sanksionesh për shkeljet e dispozitave kombëtare të miratuara në zbatim të kësaj direktive dhe duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që këto sanksione të aplikohen. Këto sanksione të parashikuara duhet të jenë efikase, proporcionale dhe shtrënguese.

44. Duhet të bëhen parashikime për të drejtën e rishikimit gjyqësor të vendimeve të marra nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare në lidhje me zbatimin e kësaj direktive.

45. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, për të arritur objektivin themelor, është e nevojshme dhe e përshtatshme të sigurohet plotësimi i një tregu të vetëm titujsh për të përcaktuar rregullat e një pasaporte të vetme për emetuesit. Kjo direktivë nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për të arritur objektivat e ndjekura në përputhje me paragrafin e tretë të nenit 5 të Traktatit.

46. Vlerësimi i bërë nga Komisioni për zbatimin e kësaj direktive duhet të përqendrohet veçanërisht në procesin e miratimit të prospekteve nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare, dhe në përgjithësi për zbatimin e parimit të vendit të origjinës, dhe nëse, nga zbatimi i saj, mund të rezultojnë probleme të mbrojtjes së investitorëve dhe efikasitetit të tregut; Komisioni duhet të shqyrtojë edhe funksionimin e nenit 10.

47. Për zhvillimet e ardhshme të kësaj direktive, duhet t'i jepet rëndësi çështjes së vendosjes se cilat mekanizma miratimi duhet të përcaktohen për të përmirësuar më tej zbatimin uniform të legjislacionit të komunitetit mbi prospektet, duke përfshirë edhe mundësinë e krijimit të Njësisë Evropiane për Titujt.

48. Kjo direktivë respekton të drejtat themelore dhe parimet e njohura veçanërisht nga Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian.

49. Masat e nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje duhet të miratohen në përputhje me Vendimin e Këshillit 1999/468/KE të 28 Qershorit 1999 që përcakton procedurat për ushtrimin e kompetencave zbatuese që i delegohen Komisionit ⁽¹¹⁾,

MIRATOJNË KËTË DIREKTIVË:

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Qëllimi i kësaj direktive është harmonizimi i kërkesave për hartimin, miratimin dhe shpërndarjen e prospektit që do të publikohet kur titujt do të ofrohen në publik apo do të pranohen për tregtim në një treg të rregulluar apo që operon brenda një shteti anëtar.

2. Kjo direktivë nuk zbatohet për:

(a) kuotat e emetuara nga sipërmarrjet e investimeve kolektive, përveç atyre të llojit të mbyllur;

(b) titujt të tjerë të emetuar nga shtetet anëtare apo nga autoritetet rajonale apo vendore të një shteti anëtar, nga autoritete ndërkombëtare publike ku bëjnë pjesë një ose më shumë shtete anëtare, nga Banka Qendrore Evropiane ose nga bankat qendrore të shteteve anëtare;

(c) aksionet e kapitalit të bankave qendrore të shteteve anëtare;

(d) titujt e garantuar në mënyrë të pakushtëzuar dhe të pakthyeshme nga shtetet anëtare apo nga ndonjë autoritet rajonal ose vendor i një shteti anëtar;

(e) titujt e emetuar nga shoqëri me status ligjor ose autoritete jo-fitimprurëse, të njohura nga një shtet anëtar, me qëllim përfitimin e mjeteve të nevojshme për të arritur objektivat e tyre jo-fitimprurëse;

(f) titujt të tjerë të emetuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur nga institucione kredituese, me kusht që këto tituj:

(i) të mos jenë nënrenditës, të konvertueshëm apo të këmbyeshëm;

(ii) të mos japin të drejtën për nënshkrimin apo blerjen e llojeve të tjera titujsh dhe të mos jenë të lidhur me ndonjë instrument derivativ;

(iii) të materializojnë marrjen e depozitave që mund të shlyhen;

(iv) të mbulohen nga një skemë garancie e depozitave sipas Direktivës 94/19/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi skemat e garancisë së depozitave⁽¹²⁾;

(g) aksione të pazëvendësueshme të kapitalit, qëllimi kryesor i të cilave është t'i sigurojnë mbajtësit mundësinë që të zërë një apartament, ose ndonjë formë tjetër pasurie të paluajtshme apo një pjesë të saj dhe ku aksionet të mos mund të shiten pa iu hequr kjo e drejtë;

(h) tituj të përfshirë në një ofertë ku shuma totale e ofertës është më pak se 2 500 000 euro, limiti i së cilës do të llogaritet për një periudhë prej 12 muajsh;

(i) "obligacione hipotekore" të lëshuara vazhdimisht nga një institucion kreditor në Suedi qëllimi kryesor i të cilës është të japë kredi hipotekore, me kusht që

(i) "obligacionet hipotekore" të emetuara të jenë të së njëjtës seri;

(ii) "obligacionet hipotekore" të emetohen menjëherë gjatë një periudhe të specifikuar lëshimi;

(iii) kushtet e përgjithshme të "obligacionit hipotekor" të mos ndryshohen gjatë periudhës së emetimit;

(iv) shumat që rrjedhin nga emetimi i "obligacionit hipotekor", në përputhje me statutin e emetuesit, të regjistrohesh në ato aktive që ofrojnë mbulim të mjaftueshëm për detyrimin që rrjedh nga titujt;

(j) titujt të tjerë të emetuar në mënyrë të vazhdueshme ose të përsëritur nga ana e institucioneve kreditore ku shuma totale e ofertës është më pak se 50 000 000 euro, limiti i së cilës do të llogaritet për një periudhë prej 12 muajsh, me kusht që këto titujt:

(i) të mos jenë nënrenditës, të konvertueshëm apo të këmbyeshëm;

(ii) të mos japin të drejtën për nënshkrimin apo blerjen e llojeve të tjera titujsh dhe të mos jenë të lidhur me ndonjë instrument derivativ.

3. Pavarësisht paragrafit 2, germa (b), (d), (h), (i) dhe (j), emetuesi, ofruesi apo një person që kërkon miratim të tregtojnë në një treg të rregulluar gëzon të drejtën të hartojë një prospekt në përputhje me këtë direktive kur titujt i ofrohen publikut apo pranohen për t'u tregtuar.

Neni 2

Përkufizimet

1. Për qëllime të kësaj direktive, përdoren përkufizimet e mëposhtme:

(a) "tituj" janë tituj të transferueshëm, siç përcaktohet në nenin 1 paragrafi 4 të Direktivës 93/22/KEE me përjashtim të instrumenteve të tregjeve valutore, siç përcaktohet në nenin 1 paragrafi 5 të Direktivës 93/22/KEE, me afat maturimi më pak se 12 muaj. Për këto instrumente mund të zbatohet legjislacioni i brendshëm;

(b) "tituj të kapitalit aksionar" janë aksione dhe tituj të transferueshëm të barasvlershëm me aksionet në një shoqëri; si dhe çdo lloj tjetër titujsh të transferueshëm që japin të drejtën për të blerë titujt e sipërpërmendur, si rrjedhojë e konvertimit të tyre apo ushtrimit të të drejtave që lidhen me to, me kusht që këto të fundit të emetohen nga emetues të aksioneve themeluese ose nga një subjekt që i përket grupit të emetuesit në fjalë;

(c) "titujt të tjerë" janë të gjithë titujt që nuk janë tituj të kapitalit aksionar;

(d) "ofrimi i titujve për publikun" është një komunikatë që i drejtohet publikut, në çfarëdo formë dhe me anë të çfarëdo mjeti, ku jepet informacion i mjaftueshëm mbi kushtet e ofertës dhe titujt që ofrohen, për t'i mundësuar një investitori të vendosë të blejë ose të nënshkruajë këta tituj. Ky përkufizim është i zbatueshëm edhe për vendosjen e titujve përmes ndërmjetësve financiarë;

(e) "investitorë të kualifikuar" janë:

(i) persona juridikë të autorizuar ose të rregulluar për të operuar në tregjet financiare, duke përfshirë: institucionet kredituese, firmat investuese, institucione financiare të tjera të autorizuara ose të rregulluara, shoqëritë e sigurimit, skemat e investimeve kolektive dhe shoqëritë administruese të tyre, fondet e pensioneve dhe shoqëritë administruese të tyre, tregtarët e mallrave për përdorim të gjerë, si dhe subjekte të paautorizuar apo të rregulluara si më lartë, të cilat kanë si objekt vetëm investimin në tituj;

(ii) njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore, bankat qendrore, institucionet ndërkombëtare dhe multinacionale të tilla si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve dhe të tjera organizata ndërkombëtare të ngjashme;

(iii) persona të tjerë juridikë që nuk plotësojnë dy nga tre kriteret e përcaktuara në paragrafin (f);

(iv) persona fizikë të caktuar: me miratim të përbashkët, një shtet anëtar mund të zgjedhë të autorizojë persona fizikë të cilët janë rezident në shtetin anëtar dhe që shprehimisht kërkojnë të konsiderohen si investitorë të kualifikuar, nëse këta persona plotësojnë të paktën dy nga kriteret e përcaktuara në paragrafin 2;

(v) SME të caktuara: me miratim të përbashkët, një shtet anëtar mund të zgjedhë të autorizojë SME-të që kanë seli të regjistruara në atë shtet anëtar dhe që shprehimisht kërkojnë të konsiderohen si investitorë të kualifikuar;

(f) "ndërmarrjet e vogla dhe të mesme" janë shoqëri të cilat, sipas llogarive të tyre të fundit të konsoliduara ose atyre vjetore, plotësojnë të paktën dy nga tre kriteret në vijim: kanë mesatarisht më pak se 250 punëmarrës gjatë vitit financiar, kanë bilanc të përgjithshëm prej jo më shumë se 43 000 000 euro dhe një xhiro vjetore neto që nuk kalon 50 000 000 euro;

(g) "institucione kredituese" është një sipërmarrje e përkufizuar në nenin 1, paragrafi 1, germa (a) të Direktivës 2000/12/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 20 marsit 2000, për krijimin dhe funksionimin e veprimtarisë tregtare të institucioneve kredituese (¹³);

(h) "emetues" është një person juridik që emeton ose propozon të emetojë tituj;

(i) "personi që bën ofertën" (ose "ofertuesi") është një person juridik ose individ që ofron tituj për publikun;

(j) "treg i rregulluar" është një treg sipas përkufizimit që i jepet në nenin 1, paragrafi 13 të Direktivës 93/22/KEE;

(k) "program ofrimi" është një plan që lejon emetimin e titujve të tjerë, duke përfshirë garancitë e çdo forme, që janë të ngjashme në lloj dhe/ose klasë, në një mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur gjatë një periudhe të caktuar emetimi;

(l) "tituj të emtuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur" janë emetime të menjëhershme ose të paktën dy emetime të ndara titujsh që janë të ngjashme në lloj dhe/ose klasë, gjatë një periudhë 12 mujore;

(m) "shtet anëtar i origjinës" është:

(i) shteti anëtar ku emetuesi ka selinë e regjistruar, për të gjithë ata emetues titujsh, të Komunitetit, që nuk përmenden në pikën (ii);

(ii) shteti anëtar ku është regjistruar selia e emetuesit, ose ku titujt kanë qenë ose do të lejohen të tregtohen në një treg të rregulluar ose ku titujt i ofrohen publikut, sipas zgjedhjes së emetuesit, ofertuesit apo personit që ka kërkuar pranimin, sipas rastit, për të gjithë ata emetues titujsh të tjerë, prerja për njësi e të cilëve është të paktën në shumën 1000 euro, dhe për çdo emetues titujsh të tjerë ka të drejtë të blejë tituj të transferueshëm ose të marrë një sasi parash në dorë, si rrjedhojë e konvertimit

të atyre titujve apo e ushtrimit të të drejtave që lidhen me ato tituj, me kusht që emetuesi i titujve të tjerë mos jetë emetuesi i titujve themelor apo ndonjë subjekt që i përket grupit të këtij emetuesi. I njëjti regjim ndiqet për titujt të tjerë që nuk janë në monedhën euro, me kusht që vlera e prerjes minimale të jetë afërsisht e barasvlershme me 1000 euro;

(iii) për të gjithë emetuesit e titujve të themeluar në një vend të tretë, të cilët nuk përmenden në pikën (ii), shteti anëtar ku titujt pritet t'i ofrohen publikut për herë të parë pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj direktive ose ku do të bëhet aplikimi i parë për pranim për tregtim në një treg të rregulluar, sipas zgjedhjes së emetuesit, ofertuesit ose personit që kërkon pranimin, sipas rastit, që i nënshtrohet një zgjedhjeje të mëvonshme nga emetuesit e themeluar në një vend të tretë, në rast se shteti anëtar i origjinës nuk është caktuar sipas zgjedhjes së tyre;

(n) "shtet anëtar pritës" është shteti ku një ofertë bëhet publike ose ku kërkohet pranim për tregtim, në rast se është i ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës;

(o) "sipërmarrje e investimeve kolektive, përveç atyre të tipit të mbyllur" janë fonde kujdestarie ose shoqëri investimi:

(i) objekti i të cilave është investimi kolektiv i kapitalit të dhënë nga publiku dhe që operojnë me parimin e shpërndarjes së riskut;

(ii) kuota të cilat, me kërkesë të mbajtësit, riblihen ose shlyhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga aktive e këtyre sipërmarrjeve;

(p) "kuota të një sipërmarrjeje investimesh kolektive" janë tituj të emetuar nga sipërmarrja e investimeve kolektive, të cilët përfaqësojnë të drejtat e pjesëmarrësve të kësaj sipërmarrjeje mbi aktivet e saj;

(q) "miratim" është përgjigjja pozitive e autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës në përfundim të shqyrtimit nëse prospekti ka qenë i plotë dhe nëse informacioni i dhënë në të ka qenë konsistent dhe i kuptueshëm;

(r) "prospekti bazë" është prospekti që përmban të gjithë informacionin përkatës të specifikuar në nenet 5, 7 dhe 16 në rast se do të ketë shtesa në lidhje me emetuesin dhe titujt e ofruar për publikun apo të pranuar për tregtim, dhe kushtet përfundimtare të ofertës, sipas zgjedhjes së emetuesit.

2. Për qëllime të paragrafit 1, germa (e), pika (iv), kriteret janë si më poshtë:

(a) investitori ka kryer transaksione të një madhësie të konsiderueshme në tregjet e titujve, mesatarisht të paktën 10 transaksione në tre muaj, gjatë katër tremujorëve paraardhës;

(b) madhësia e portofolit të titujve të investitorit kalon 0,5 milionë euro;

(c) investitori punon apo ka punuar për të paktën një vit në sektorin financiar në një pozicion profesional që kërkon njohuri të investimeve në tituj.

3. Për qëllime të paragrafit 1, germa (e), pika (iv) dhe (v), vlejnjë pikat e mëposhtme:

Çdo autoritet kompetent siguron se janë vendosur mekanizmat e duhur për regjistrimin e një personi fizik dhe të SME-ve të cilët konsiderohen si investitor të kualifikuar, duke marrë parasysh nevojën për

të siguruar nivelin e duhur të mbrojtjes së të dhënave. Regjistri u vihet në dispozicion të gjithë emetuesve. Çdo person fizik apo SME që dëshiron të konsiderohet si investitor i kualifikuar duhet të regjistrohet dhe çdo investitor i regjistruar mund të vendosë të tërhiqet në çdo moment.

4. Që të merren parasysh zhvillimet teknike në tregjet financiare dhe për të siguruar zbatimin uniform të kësaj direktive, Komisioni, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 24, paragrafi 2, miraton masat zbatuese në lidhje me përkufizimet e përmendura në paragrafin 1, duke përfshirë edhe rregullimin e shifrave të përdorura për përkufizimin e SME-ve, duke marrë parasysh legjislacionin komunitar dhe rekomandimet, si dhe zhvillimet ekonomike dhe masat për nxjerrjen e informacionit që kanë të bëjnë me regjistrimin e investitorëve të kualifikuar individual.

Neni 3

Detyrimi për të publikuar një prospekt

1. Shtetet anëtare nuk do të lejojnë që ofrimi i titujve të bëhet publik brenda territoreve të tyre pa publikimin paraprak të prospektit.

2. Detyrimi për të publikuar një prospekt nuk zbatohet për llojet e mëposhtme të ofertave:

(a) një ofertë për tituj që u drejtohet vetëm investitorëve të kualifikuar; dhe/ose

(b) një ofertë për tituj që u drejtohet më pak se 100 personave fizikë ose juridikë për çdo shtet anëtar, përveç investitorëve të kualifikuar; dhe/ose

(c) një ofertë për tituj që u drejtohet investitorëve që blejnë tituj kundrejt një vlere totale prej të paktën 50 000 euro për investitor, për çdo ofertë të veçantë; dhe/ose

(d) një ofertë për tituj, prerja e të cilëve për kuota ka të paktën vlerën 50 000 euro; dhe/ose

(e) një ofertë për tituj me një vlerë totale prej më pak se 100 000 euro, kufiri i së cilës do të llogaritet për një periudhë 12 mujore.

Megjithatë, çdo rishitje e mëvonshme e titujve të cilët më parë ishin objekt i një ose më shumë llojeve të ofertave të përmendura në këtë paragraf, do të konsiderohet si një ofertë e veçantë dhe përkufizimi i përcaktuar në nenin 2, paragrafi 1, germa (d), do të zbatohen me qëllim që të vendoset nëse rishitja është një ofertë e titujve për publikun. Vendosja e titujve mes ndërmjetësve financiarë i nënshtrohet publikimit të prospektit, nëse nuk është plotësuar asnjë nga kushtet nga (a) deri në (e) për vendosjen përfundimtare.

3. Shtetet anëtare sigurojnë që çdo pranim i titujve për tregtim në një treg të rregulluar që gjendet apo që operon në territoret e tyre, t'i nënshtrohet publikimit të prospektit.

Neni 4

Përjashtime nga detyrimi i publikimit të prospektit

1. Detyrimi për të publikuar një prospekt nuk zbatohet për llojet e mëposhtme të titujve që i ofrohen publikut:

(a) aksionet e emetuara për të zëvendësuar aksionet e së njëjtës klasë të emetuara më parë, nëse emetimi i këtyre aksioneve të reja nuk ka të bëjë me ndonjë rritje në kapitalin e emetuar;

(b) titujt e ofruar në lidhje me blerjen përmes këmbimit, me kusht që të vihet në dispozicion një dokument me informacione, të cilin autoritet kompetente e konsiderojnë të barasvlershëm me prospektin, duke marrë parasysh kërkesat e legjislacionit komunitar;

(c) titujt e ofruar, të ndarë ose që do të ndahen në lidhje me një bashkim, me kusht që të vihet në dispozicion një dokument me informacione, të cilin autoritet kompetente e konsiderojnë të barasvlershëm me prospektin, duke marrë parasysh kërkesat e legjislacionit komunitar;

(d) aksionet e ofruara, të ndara ose që do të ndahen falas për aksionarët ekzistues dhe dividenti i paguar në formën e aksioneve të së njëjtës klasë me aksionet për të cilat është paguar dividenti, me kusht që të vihet në dispozicion një dokument me informacione mbi numrin dhe natyrën e aksioneve dhe arsyet dhe detajet e ofertës;

(e) tituj që u janë ofruar, që u janë ndarë ose që do t'u ndahen ish-drejtorëve apo drejtorëve ekzistues apo punëmarrësve nga punëdhënësi i tyre që ka tituj të pranuar më parë për tregtim në një treg të rregulluar ose nga një sipërmarrje e lidhur, me kusht që të vihet në dispozicion një dokument me informacione mbi numrin dhe natyrën e titujve dhe arsyet dhe detajet e ofertës.

2. Detyrimi për të publikuar një prospekt nuk zbatohet për pranimin për tregtim në një treg të rregulluar, të llojeve të mëposhtme të titujve:

(a) aksione që përfaqësojnë, për një periudhë prej 12 muaj, më pak se 10 përqind të numrit të aksioneve të së njëjtës klasë, të pranuar më parë për tregtim në të njëjtin treg të rregulluar;

(a) aksionet e emetuara për të zëvendësuar aksionet e së njëjtës klasë të pranuar më parë për tregtim në të njëjtin treg të rregulluar, nëse emetimi i këtyre aksioneve nuk ka të bëjë me ndonjë rritje të kapitalit të emetuar;

(c) titujt e ofruar në lidhje me një blerje përmes këmbimit, me kusht që të vihet në dispozicion një dokument me informacione, të cilin autoritet kompetente e konsiderojnë të barasvlershëm me prospektin, duke marrë parasysh kërkesat e legjislacionit komunitar;

(d) titujt e ofruar, të ndarë ose që do të ndahen në lidhje me një bashkim, me kusht që të vihet në dispozicion një dokument me informacione, të cilin autoritet kompetente e konsiderojnë të barasvlershëm prospektin, duke marrë parasysh kërkesat e legjislacionit komunitar;

(e) aksionet e ofruara, të ndara ose që do të ndahen falas për aksionarët ekzistues dhe dividenti i paguar në formën e aksioneve të së njëjtës klasë me aksionet për të cilat është paguar dividenti, me kusht që të njëjtat aksione të jenë të së njëjtës klasë me aksionet e pranuar më parë për tregtim në të njëjtin treg të rregulluar dhe që të vihet në dispozicion një dokument me informacione mbi numrin dhe natyrën e aksioneve, arsyet dhe detajet e ofertës;

(f) tituj që u janë ofruar, që u janë ndarë ose që do t'u ndahen ish-drejtorëve apo drejtorëve ekzistues apo punëmarrësve nga punëdhënësi i tyre apo një sipërmarrje e lidhur, me kusht që këta tituj të jenë të së njëjtës klasë me titujt e pranuar më parë për tregtim në të njëjtin treg të rregulluar dhe që të vihet në dispozicion një dokument me informacione mbi numrin dhe natyrën e titujve, arsyet dhe detajet e ofertës;

(g) aksione që rezultojnë nga konvertimi apo shkëmbimi i titujve të tjerë apo nga ushtrimi i të drejtave të akorduara nga tituj të tjerë, me kusht që këto aksione të jenë të së njëjtës klasë me aksionet e pranuar më parë për tregtim në të njëjtin treg të rregulluar;

(h) tituj të pranuar më parë për tregtim në një tjetër treg të rregulluar, sipas kushteve të mëposhtme:

(i) këto tituj apo titujt e së njëjtës klasë të jenë pranuar për tregtim në ato tregje të tjera të rregulluara për një periudhë më shumë se 18 muaj;

(ii) për titujt e pranuar më parë për tregtim në një treg të rregulluar pas hyrjes në fuqi të kësaj direktive, pranimi për tregtim në tregun tjetër të rregulluar të jetë shoqëruar me një prospekt të miratuar, të bërë publik në përputhje me nenin 14;

(iii) përveçse kur gjen zbatim pika ii, për titujt e pranuar më parë për listim, pas 30 Qershorit 1983, detajet e listimit të kenë qenë të miratuara në përputhje me kërkesat e Direktivës 80/390/KEE ose Direktivës 2001/34/KE;

(iv) të përmbushen detyrimet e vazhdueshme për tregtim në atë treg tjetër të rregulluar;

(v) personi që kërkon pranimin e një titulli për tregtim në një treg të rregulluar, sipas këtij përjashtimi, të hartojë një dokument përmbledhës për publikun në një gjuhë të pranuar nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të tregut të rregulluar ku kërkohet pranimi;

(vi) dokumenti përmbledhës sipas pikës v të bëhet publik në shtetin anëtar të tregut të rregulluar ku kërkohet pranimi për tregtim, sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 14, paragrafi 2; dhe

(vii) përmbajtja e dokumentit përmbledhës të jetë në përputhje me nenin 5, paragrafi 2. Për më tepër, në dokument duhet të jepet vendi ku mund të gjendet prospekti më i fundit dhe informacioni financiar i publikuar nga emetuesi, sipas detyrimit të tij të vazhdueshëm për të dhënë informacion.

3. Që të merren parasysh zhvillimet teknike në tregjet financiare dhe që të sigurohet zbatimi uniform i kësaj direktive, Komisioni, në përputhje me procedurën sipas nenit 24, paragrafi 2, miraton masat zbatuese në lidhje me paragrafët 1, germa (b), 1, germa (c), 2, germa (c) dhe 2, germa (d), veçanërisht në lidhje me kuptimin e ekuivalencës.

KAPITULLI II

HARTIMI I PROSPEKTIT

Neni 5

Prospekti

1. Pa cenuar nenin 8, paragrafi 2, prospekti duhet të përmbajë të gjithë informacionin e nevojshëm, sipas natyrës së veçantë të emetuesit dhe titujve të ofruar publikut apo të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, për të siguruar që investitorët të kryejnë një vlerësim të informuar të aktiveve dhe pasiveve, fitimit dhe humbjeve, gjendjes dhe perspektivave financiare të emetuesit dhe të çdo dorëzanësi dhe të të drejtave që lidhen me këto tituj. Ky informacion duhet të paraqitet në një formë lehtësisht të analizueshme dhe të kuptueshme.

2. Prospekti përmban informacion në lidhje me emetuesin dhe titujt që do t'u ofrohen publikut apo që do të pranohen për tregtim në një treg të rregulluar. Përmban gjithashtu edhe një përmbledhje. Përmbledhja jep shkurtimisht dhe në gjuhë jo teknike, karakteristikat thelbësore dhe risqet që lidhet me emetuesin, me çdo dorëzanës dhe me titujt, në gjuhën në të cilën është hartuar prospekti. Përmbledhja duhet të përmbajë një paralajmërim se:

(a) ajo duhet të konsiderohet si hyrje e prospektit;

(b) çdo vendim për të investuar në tituj duhet të bazohet në analizimin e prospektit në tërësi nga investitori;

(c) në rast se paraqitet në gjykatë ndonjë pretendim në lidhje me informacionin që përmban prospekti, investitori paditës, sipas legjislacionit të brendshëm të shtetit anëtar, paguan kostot e përkthimit të prospektit përpara se të fillojë procedura ligjore; dhe

(d) detyrimi civil lind për ata persona që kanë hartuar përmbledhjen duke përfshirë çdo përkthim të saj dhe që kanë aplikuar për njoftimin e saj, vetëm nëse përmbledhja është çorientuese, e pasaktë ose jokonsistente kur lexohet bashkë me pjesët e tjera të prospektit.

Kur prospekti lidhet me pranimin për tregtim të titujve të tjerë në një treg të rregulluar, me prerje 50 000 euro, nuk është e nevojshme të jepet një përmbledhje, përveçse kur kërkohet nga një shtet anëtar, sipas nenit 19, paragrafi 4.

3. Duke iu nënshtruar paragrafit 4, emetuesi, ofertuesi apo personi që kërkon pranimin për të tregtuar në një treg të rregulluar, mund të hartojë prospektin si një dokument të vetëm ose si dokumente të veçanta. Në një prospekt të përbërë nga dokumente të veçanta, informacioni i kërkuar ndahet në dokumente regjistrimi, shënime për titujt dhe përmbledhje. Dokumenti i regjistrimit përmban informacion mbi emetuesin. Shënimet për titujt përmbajnë informacion në lidhje me titujt e ofruar publikut apo që do të pranohen për tregtim në një treg të rregulluar.

4. Për llojet e mëposhtme të titujve dhe sipas zgjedhjes së emetuesit, ofertuesit apo personit që kërkon pranim për tregtim në një treg të rregulluar, prospekti mund të përbëhet nga një prospekt bazë që përmban të gjithë informacionin përkatës për emetuesin dhe titujt që i ofrohen publikut apo që do të pranohen për tregtim në një treg të rregulluar:

(a) tituj të tjerë, duke përfshirë garanci të çdo forme, të emetuar sipas një programi ofrimi;

(b) tituj të tjerë të emetuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur nga institucione kredituese,

(i) kur shumat që rrjedhin nga emetimi i këtyre titujve, sipas legjislacionit të brendshëm, u shtohen aktiveve që sigurojnë mbulim të mjaftueshëm për detyrimin që rrjedh nga titujt deri në datën e tyre të maturimit;

(ii) kur, në rast falimenti të institucionit kreditues përkatës, këto shuma konsiderohen si prioritare për shlyerjen e kapitalit dhe interesit që duhet paguar, pa cenuar dispozitat e Direktivës 2001/24/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 4 Prillit 2001 mbi riorganizimin dhe falimentimin e institucioneve kredituese ⁽¹⁴⁾.

Informacioni i dhënë në prospektin bazë, nëse lind nevoja, në përputhje me nenin 16, plotësohet me informacion të përditësuar mbi emetuesin dhe titujt që do t'u ofrohen publikut apo që do të pranohen për tregtim në një treg të rregulluar.

Nëse kushtet përfundimtare të ofertës nuk përfshihen as në prospektin bazë dhe as në ndonjë shtesë të tij, kushtet përfundimtare u jepen investitorëve dhe depozitohen pranë autoriteteve kompetente sa herë që bëhet një ofertë publike, sa më shpejt të jetë e mundur dhe mundësisht përpara fillimit të ofertës. Dispozitat e nenit 8, paragrafi 1, germa (a) aplikohen në çdo rast të tillë.

5. Që të merren parasysh zhvillimet teknike në tregjet financiare dhe që të sigurohet zbatimi uniform i kësaj direktive, Komisioni, në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 24, paragrafi 2, miraton masat zbatuese në lidhje me formatin e prospektit apo të prospektit bazë dhe shtesave të tij.

Neni 6

Përgjegjësia që lidhet me prospektin

1. Shtetet anëtare sigurojnë që përgjegjësia për informacionin e paraqitur në një prospekt t'i ngarkohet, sipas rastit, të paktën emetuesit ose organeve të tij administrative, menaxhuese apo mbikëqyrëse, ofruesit, personit që kërkon pranim për tregtim në një treg të rregulluar ose dorëzanësit. Personat përgjegjës identifikohen qartësisht në prospekt me emrin e tyre dhe funksionet që kanë, ose në rastin e personave juridik, me emrin dhe adresën e regjistruar, si dhe me anë të një deklaratë prej tyre që, për aq sa ata kanë dijeni, informacioni që përmban prospekti është në përputhje me faktet dhe se nga ai nuk është hequr asgjë që mund të ndikojë në kuptimin e tij.

2. Shtetet anëtare sigurojnë që legjislacioni, rregullorja dhe dispozitat administrative të tyre për detyrimet civile, të gjejnë zbatim për ata persona që janë përgjegjës për informacionin e dhënë në prospekt.

Megjithatë, shtetet anëtare garantojnë që një person të mos mbajë përgjegjësi civile për përmbledhjen, përfshirë çdo përkthim të saj, nëse përmbledhja nuk është çorientuese, e pasaktë ose jokonsistente me pjesët e tjera të prospektit.

Neni 7

Informacioni minimal

1. Komisioni, në përputhje me procedurën sipas nenit 24, paragrafi 2, miraton masa të detajuara zbatuese në lidhje me informacione të veçanta që përfshihen në prospekt, duke shmangur dublikimin e informacionit kur prospekti përbëhet nga dokumente të veçanta. Grupi i parë i masave zbatuese miratohet deri më 1 Korrik 2004.

2. Në veçanti, sa i përket shqyrtimit të modeleve të ndryshme të prospekteve, merren parasysh faktorët e mëposhtëm:

(a) llojet e ndryshme të informacionit të nevojshëm për investitorët në lidhje me titujt të kapitalit aksionar në krahasim me titujt të tjerë ; do të mbahet një qasje e qëndrueshme për informacionin e kërkuar në një prospekt për titujt që kanë një bazë të ngjashme ekonomike, sidomos për titujt derivativë;

(b) llojet e ndryshme dhe karakteristikat e ofertave dhe pranimeve për tregtim në një treg të rregulluar të titujve të tjerë . Informacioni i kërkuar në një prospekt duhet të jetë i përshtatshëm nga pikëpamja e investitorëve të interesuar për titujt të tjerë që kanë prerje për njësi prej të paktën 50 000 euro;

(c) formatin e përdorur dhe informacionin e kërkuar në prospektet që lidhen me titujt të tjerë , duke përfshirë garancitë e çdo forme të emetuara në bazë të një programi ofrimi;

(d) formatin e përdorur dhe informacionin e kërkuar në prospektet që lidhen me titujt të tjerë, deri në masën që këto tituj të mos jenë nënrenditës, të konvertueshëm, të këmbyeshëm, objekt i të drejtave të nënshkrimit apo blerjes apo të lidhura me instrumentet derivative, të emtuar në mënyrë të vazhdueshme ose të përsëritur nga subjekte të autorizuar apo të rregulluara për të operuar në tregjet financiare brenda Zonës Ekonomike Evropiane;

(d) veprimtaritë e ndryshme dhe madhësia e emetuesit, në veçanti SME-të. Për këto shoqëri, informacioni duhet të përshtatet me madhësinë e tyre dhe, kur është e përshtatshme, me bazën e tyre të fundit të të dhënave;

(f) natyrën publike të emetuesit, nëse është rasti.

3. Masat zbatuese sipas paragrafit 1, bazohen në standardet e fushës së informacionit financiar dhe jofinanciar të vendosura nga organizatat ndërkombëtare të komisioneve të letrave me vlerë, dhe në veçanti nga IOSCO dhe mbi Shtojcat treguese të kësaj direktive.

Neni 8

Heqja e informacionit

1. Shtetet anëtare sigurojnë që, në rast se çmimi përfundimtar i ofertës dhe shuma e titujve që do t'i ofrohen publikut nuk mund të përfshihen në prospekt:

(a) kriteret dhe/ose kushtet, në përputhje me të cilat do të përcaktohen elementët e mësipërm, ose në rastin e çmimit, çmimi maksimal, të jepen në prospekt; ose

(b) pranimi për blerjen apo nënshkrimi i titujve mund të tërhiqet për jo më pak se dy ditë pune pasi të jetë depozituar çmimi përfundimtar i ofertës dhe shuma e titujve që do t'i ofrohen publikut.

Çmimi i ofertës përfundimtare dhe shuma e titujve depozitohen pranë autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës dhe publikohen në përputhje me masat e parashikuara në nenin 14, paragrafi 2.

2. Sipas kësaj direktive ose sipas masave zbatuese të përmendura në nenin 7, paragrafi 1, autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës mund të autorizojë heqjen e një informacioni të caktuar nga prospekti, nëse:

(a) dhënia e një informacioni të tillë do të ishte kundër interesit publik; ose

(b) dhënia e një informacioni të tillë do të ishte shumë e dëmshme për emetuesin, me kusht që mosdhënia e tij të mos çorientojë publikun në lidhje me faktet dhe rrethanat thelbësore për një vlerësim të informuar të emetuesit, ofertuesit apo dorëzanësit, nëse ka, dhe të të drejtave lidhur me titujt për të cilët është nxjerrë prospekti; ose

(c) ky informacion ka një rëndësi minimale vetëm për një ofertues të veçantë apo për pranimin për tregtim në një treg të rregulluar dhe nuk do të ndikojë në vlerësimin e gjendjes dhe perspektivës financiare të emetuesit, ofertuesit apo dorëzansit, nëse ka.

3. Pa cenuar informacionin e saktë për investitorët, kur në raste të veçanta, informacioni specifik, që kërkohet të përfshihet në prospekt sipas masave zbatuese të përmendura në nenin 7, paragrafi 1, nuk është i përshtatshëm për sferën e veprimtarisë së emetuesit, për formën ligjore të tij apo për titujt me të cilat lidhet prospekti, ky prospekt duhet të përmbajë informacion të barasvlershëm me informacionin e kërkuar. Nëse ky informacion nuk ekziston, kjo kërkesë nuk gjen zbatim.

4. Që të merren parasysh zhvillimet teknike në tregjet financiare dhe që të sigurohet zbatimi uniform i kësaj direktive, Komisioni, në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 24, paragrafi 2, miraton masat zbatuese në lidhje me paragrafin 2.

Neni 9

Vlefshmëria e prospektit, prospektit bazë dhe dokumentit të regjistrimit

1. Një prospekt është i vlefshëm për 12 muaj pas publikimit të tij për ofertat për publikun apo pranimet për tregtim në tregjet e rregulluara, me kusht që prospekti të plotësohet nga çdo lloj shtese e kërkuar sipas nenit 16.

2. Në rastin e një programi ofrimi, prospekti bazë, i dorëzuar më parë, mbetet i vlefshëm për një periudhë 12 mujore.

3. Në rastin e titujve, të tjerë sipas nenit 5, paragrafi 4, germa (b), prospekti mbetet i vlefshëm deri sa mos të emetohet më asnjë titull që ka lidhje me të, në mënyrë të vazhdueshme ose të përsëritur.

4. Një dokument regjistrimi i dorëzuar më parë, sipas nenit 5, paragrafi 3, është i vlefshëm për një periudhë deri në 12 muaj, me kusht që të përditësohet në përputhje me nenin 10, paragrafi 1. Dokumenti i regjistrimit bashkë me shënimin mbi titujt, i përditësuar, sipas rastit, në përputhje me nenin 12, dhe përmbledhja konsiderohen si një prospekt i vlefshëm.

Neni 10

Informacioni

1. Emetuesit, titujt e të cilëve janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, duhet që të paktën një herë në vit të nxjerrin një dokument që përmban apo i referohet të gjithë informacionit që kanë publikuar apo kanë vënë në dispozicion të publikut gjatë 12 muajve pararendës në një ose më shumë shtete anëtare dhe në vende të treta, në përputhje me detyrimet e tyre sipas legjislacionit dhe rregullave komunitare ose atyre të brendshme, që kanë të bëjnë me rregullimin e titujve, emetuesve të titujve dhe tregjeve të titujve. Emetuesit duhet t'u referohen të paktën informacioneve të kërkuar sipas direktivave ligjtit për shoqëritë, Direktivës 2001/34/KE dhe Rregullores (KE) nr. 1606/2002 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 19 Korrikut 2002 për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit⁽¹⁴⁾.

2. Dokumenti depozitohet pranë autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës, pas publikimit të pasqyrave financiare. Atje ku dokumenti i referohet informacionit, duhet të përcaktohet se ku mund të merret informacioni.

3. Detyrimi i vendosur në paragrafin 1 nuk zbatohet për emetuesit e titujve të tjerë prerja për njësi e të cilëve arrin vlerën prej të paktën 50 000 euro.

4. Që të merren parasysh zhvillimet teknike në tregjet financiare dhe që të sigurohet zbatimi uniform i kësaj direktive, Komisioni, në përputhje me procedurën e referuar në nenin 24, paragrafi 2, mund të miratojë masat zbatuese në lidhje me paragrafin 1. Këto masa lidhen vetëm me metodën e publikimit të kërkesave për nxjerrjen e informacionit, të përmendur në paragrafin 1 dhe nuk përfshijnë kërkesa të reja për informacion. Grupi i parë i masave zbatuese miratohet deri më 1 Korrik 2004.

Neni 11

Përfshirja me anë të referencës

1. Shtetet anëtare lejojnë që informacioni të përfshihet në prospekt me anë të referencës në një ose më shumë dokumente të publikuar më parë ose njëherazi, që janë miratuar nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës ose që janë depozituar në përputhje me këtë direktivë, veçanërisht sipas nenit 10, ose me Titujt IV dhe V të Direktivës 2001/34/KE. Ky informacion duhet të jetë informacioni më i fundit që disponon emetuesi. Përmbledhja nuk duhet të përfshijë informacion me anë të referencës.

2. Kur informacioni përfshihet me anë të referencës, duhet të mundësohet një listë referencash për të bërë të mundur që investitorët të identifikojnë lehtësisht pjesë të veçanta të informacionit.

3. Që të merren parasysh zhvillimet teknike në tregjet financiare dhe që të sigurohet zbatimi uniform i kësaj direktive, Komisioni, në përputhje me procedurën e referuar në nenin 24, paragrafi 2, miraton masat zbatuese në lidhje me informacionin e përfshirë me anë të referencës. Grupi i parë i masave zbatuese miratohet deri më 1 korrik 2004.

Neni 12

Prospektet që përbëhen nga dokumente të veçanta

1. Një emetues që ka një dokument regjistrimi të miratuar më parë nga autoriteti kompetent duhet të hartojë vetëm shënimet për titujt dhe përmbledhjen, kur titujt i ofrohen publikut apo kur ata pranohen për tregtim në një treg të rregulluar.

2. Në këtë rast, shënimet për titujt kanë informacionin që normalisht mundësohet edhe në dokumentin e regjistrimit, në rast se ka pasur ndonjë ndryshim material apo zhvillim të fundit që nga dokumenti më i fundit i përditësuar i regjistrimit apo është miratuar ndonjë shtesë, sipas parashikimit në nenin 16, çka do të ndikonte në vlerësimin e investitorëve. Shënimet dhe përmbledhjet i nënshtrohen një miratimi të veçantë.

3. Kur emetuesi ka depozituar vetëm një dokument regjistrimi të pa miratuar, i gjithë dokumentacioni, duke përfshirë edhe informacionin e përditësuar, duhet t'i nënshtrohet miratimit.

KAPITULLI III

MASAT PËR MIRATIMIN DHE PUBLIKIMIN E PROSPEKTIT

Neni 13

Miratimi i prospektit

1. Prospekti nuk duhet të publikohet pa u miratuar nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës.
2. Ky autoritet kompetent njofton emetuesin, ofertuesin apo personin që kërkon pranim për tregtim në një treg të rregulluar, sipas rastit, për vendimin e tij në lidhje me miratimin e prospektit, brenda 10 ditë pune nga dorëzimi i draft prospektit.

Nëse autoriteti kompetent nuk nxjerr një vendim mbi prospektin brenda afatit kohor të parashikuar në këtë paragraf dhe në paragrafin 3, kjo nuk do të konsiderohet si miratim i aplikimit.

3. Afati kohor i përmendur në paragrafin 2 zgjatet deri në 20 ditë pune nëse oferta publike përfshin tituj të emtuar nga një emetues, i cili nuk ka tituj të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar dhe që nuk ka ofruar më parë tituj për publikun.

4. Nëse autoriteti kompetent konstaton, mbi baza të arsyeshme, se dokumentet e depozituara pranë tij janë të paplota ose që nevojitet informacion shtesë, afati kohor i përcaktuar në paragrafët 2 dhe 3 zbatohet vetëm duke filluar nga data kur ky informacion jepet nga emetuesi, ofertuesi apo personi që ka kërkuar pranim për të tregtuar në një treg të rregulluar.

Në rastin e përmendur në paragrafin 2, autoriteti kompetent duhet të njoftojë emetuesin nëse dokumentet janë të plota, brenda 10 ditëve pune nga data e paraqitjes së aplikimit.

5. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës mund ta transferojë miratimin e prospektit tek një autoritet kompetent i një tjetër shteti anëtar, nëse bie dakord me atë autoritet. Për më tepër, ky transferim duhet t'i bëhet i ditur emetuesit, ofertuesit ose personit që ka kërkuar pranim për të tregtuar në një treg të rregulluar, brenda tre ditëve pune nga data e marrjes së vendimit nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës. Afati kohor i përmendur në paragrafin 2 zbatohet duke filluar nga ajo datë.

6. Kjo direktive nuk cenon përgjegjësinë e autoritetit kompetent, i cili do të vazhdojë të rregullohet vetëm nga legjislacioni i brendshëm.

Shtetet anëtare sigurojnë që dispozitat e legjislacionit të tyre të brendshëm për përgjegjësinë e autoriteteve kompetente, të zbatohen vetëm për miratimet e prospekteve nga autoriteti apo autoritetet e tyre kompetente.

7. Që të merren parasysh zhvillimet teknike në tregjet financiare dhe që të sigurohet zbatimi uniform i kësaj direktive, Komisioni, në përputhje me procedurën e referuar në nenin 24, paragrafi 2, mund të miratojë masat zbatuese në lidhje me kushtet sipas të cilave mund të përshtaten afatet kohore.

Neni 14

Publikimi i prospektit

1. Pasi të miratohet, prospekti duhet të depozitohet tek autoriteti kompetent i shtetit anëtar dhe të vihet në dispozicion të publikut nga emetuesi, ofertuesi apo personi që ka kërkuar pranim për tregtim në një treg të rregulluar, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast, në një kohë të arsyeshme para ose të paktën në fillim të ofertës publike apo pranimit për tregtim të titujve të përfshirë. Përveç kësaj, në rastin e një oferte publike fillestare të një klase aksionesh të pa pranuar më parë për tregtim në një treg të rregulluar, që do të pranohet në tregtim për herë të parë, prospekti duhet të mundësohet së paku gjashtë ditë pune përpara përfundimit të ofertës.

2. Prospekti konsiderohet i disponueshëm për publikun kur publikohet:

(a) si pjesë e një ose më shumë gazetave që qarkullojnë në treg, ose që qarkullojnë gjerësisht nëpër shtetet anëtare ku është bërë oferta për publikun ose ku është kërkuar pranimi për tregtimin; ose

(b) në formë të shtypur për t'u vënë në dispozicion të publikut, pa pagesë, në zyrat e tregut ku titujt po pranohen për tregtim, ose në selinë e emetuesit dhe në selinë e ndërmjetësve financiar që vendosin apo shesin titujt, duke përfshirë edhe agjentët pagues; ose

(c) në formë elektronike në faqen e internetit të emetuesit dhe, sipas rastit, në faqen e internetit të ndërmjetësve financiarë që vendosin apo shesin titujt, duke përfshirë edhe agjentët pagues; ose

(d) në formë elektronike në faqen e internetit të tregut të rregulluar, ku kërkohet pranimi për tregtimin; ose

(e) në formë elektronike në faqen e internetit të autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës, nëse autoriteti në fjalë ka vendosur ta ofrojë këtë shërbim.

Një shtet anëtar i origjinës mund t'u kërkojë emetuesve, që publikojnë prospektin e tyre, në përputhje me germën (a) ose (b), që ta publikojnë atë edhe në formë elektronike, në përputhje me germën (c).

3. Përveç kësaj, një shtet anëtar i origjinës mund të kërkojë publikimin e një njoftimi që tregon sesi është bërë i mundur prospekti dhe se ku mund të sigurohet ai për publikun.

4. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës publikon në faqen e tij të internetit për një periudhë prej 12 muajsh, me zgjedhjen e tij, të gjitha prospektet e miratuara, ose të paktën listën e prospekteve të miratuara në përputhje me nenin 13, duke përfshirë, sipas rastit, një lidhje të prospektit të publikuar në faqen e internetit të emetuesit ose në faqen e internetit të tregut të rregulluar.

5. Në rastin e një prospekti të përbërë nga dokumente të veçanta dhe/ose që përfshijnë informacion me anë të referencës, dokumentet dhe informacionet që përbëjnë prospektin mund të publikohen dhe të qarkullohen veçmas, me kusht që dokumentet në fjalë të vihen në dispozicion të publikut, pa pagesë, në përputhje me masat e përcaktuara në paragrafin 2. Çdo dokument tregon se ku mund të merren dokumentet e tjera përbërëse të prospektit të plotë.

6. Teksti dhe formati i prospektit, dhe/ose shtesat në prospekt, që publikohen ose vihen në dispozicion të publikut, janë gjithmonë identike me versionin origjinal të miratuar nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës.

7. Kur prospekti mundësohet me anë të publikimit në formë elektronike, pavarësisht kësaj, emetuesi, ofertuesi, personi që kërkon pranim për tregtimin apo ndërmjetësit financiarë që vendosin apo shesin titujt duhet t'i dorëzojnë investitorit edhe një kopje të printuar, me kërkesë të tij dhe pa pagesë.

8. Që të merren parasysh zhvillimet teknike në tregjet financiare dhe që të sigurohet zbatimi i njëtrajtshëm i Direktivës, Komisioni, në përputhje me procedurën e referuar në nenin 24, paragrafi 2, miraton masat zbatuese në lidhje me paragrafët 1, 2, 3 dhe 4. Grupi i parë i masave zbatuese miratohet deri më 1 Korrik 2004.

Reklama

1. Çdo lloj reklame lidhur me një ofertë publike për titujt ose me një pranim për tregtim në një treg të rregulluar do të respektojë parimet e përfshira në paragrafët 2 deri në 5. Paragrafët 2 deri në 4 zbatohen vetëm në rastet kur emetuesi, ofertuesi ose personi që aplikon për pranim për tregtim, mbulohet nga detyrimi për të hartuar një prospekt.
2. Reklammat duhet të citojnë se një prospekt është publikuar ose do të publikohen dhe tregojnë se ku mund ta gjejnë atë investitorët.
3. Reklammat duhet të jenë lehtësisht të dallueshme. Të dhënat që përmban reklama nuk duhet të jenë të pasakta ose çorientuese. Ky informacion duhet të jetë në përputhje me informacionin që përmban një prospekt, nëse është publikuar më parë, ose me informacionin që kërkohet të përfshihet në prospekt, nëse prospekti publikohet më pas.
4. Në çdo rast, i gjithë informacioni në lidhje me ofertën publike apo pranimin për tregtim në një treg të rregulluar, të paraqitura në një formë të shkruar ose verbale, edhe nëse nuk është për qëllime reklamimi, duhet të jetë në përputhje me informacionin e përfshirë në prospekt.
5. Ku nuk kërkohet prospekt sipas kësaj direktive, informacioni material i dhënë nga një emetues apo ofrues, i cili i drejtohet investitorëve të kualifikuar apo ndonjë kategorie të veçantë investitorësh, duke përfshirë informacionin e dhënë gjatë takimeve lidhur me oferta për tituj, jepet për të gjithë investitorët e kualifikuar apo kategori të veçanta investitorësh të cilëve u drejtohet ekskluzivisht oferta. Kur kërkohet publikimi i prospektit, ky informacion duhet të përfshihet në prospekt apo në ndonjë Shtojcë të tij, në përputhje me nenin 16, paragrafi 1.
6. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës ka kompetencën të ushtrojë kontroll mbi përputhshmërinë e aktivitetit reklamues në lidhje me një ofertë publike për tituj apo pranim për tregtim në një treg të rregulluar, sipas parimeve të përmendura në paragrafët 2 deri në 5.
7. Që të merren parasysh zhvillimet teknike në tregjet financiare dhe që të sigurohet zbatimi uniform i kësaj direktive, Komisioni, në përputhje me procedurën e referuar në nenin 24, paragrafi 2, miraton masat zbatuese në lidhje me shpërndarjen e reklamave që njoftojnë synimin për të ofruar tituj për publikun apo pranim për tregtim në një treg të rregulluar, veçanërisht përpara se prospekti të bëhet publik ose përpara hapjes së nënshkrimit, në lidhje me paragrafin 4. Grupi i parë i masave zbatuese miratohet nga Komisioni deri më 1 Korrik 2004.

Neni 16

Shtesat e prospektit

1. Çdo faktor i ri domethënës, gabim material apo pasaktësi në lidhje me informacionin e përfshirë në prospekt që mund të ndikojë në vlerësimin e titujve dhe që lind ose vërehet në kohën midis miratimit të prospektit dhe mbylljes së ofertës publike, dhe sipas rastit, fillimit të tregtimit në një treg të rregulluar, duhet të përmendet në një shtesë të prospektit. Një shtesë e tillë miratohet në të njëjtën mënyrë, në një kohë jo më shumë se shtatë ditë pune dhe publikohet në përputhje me të paktën të njëjtat masa të zbatuara kur u botua prospekti origjinal. Përmbledhja, dhe të gjitha përkthimet e saj, do të plotësohet nëse është e nevojshme për të marrë në konsideratë informacionin e ri të përfshira në shtesë.

2. Investitorët që kanë rënë dakord më parë të blejnë apo të nënshkruajnë tituj përpara publikimit të shtesës, kanë të drejtë të tërheqin pranimin e tyre, e drejtë e cila mund të ushtrohet brenda një afati kohor jo më të shkurtër se dy ditë pune pas publikimit të shtesës.

KAPITULLI IV

OFERTAT NDËR-KUFITARE DHE PRANIMI PËR TREGTIM

Neni 17

Qëllimi i Komunitetit për miratimin e prospekteve

1. Pa cenuar nenin 23, kur jepet një ofertë për publikun apo për pranim për tregtim në një treg të rregulluar për një ose më shumë Shtete anëtare, prospekti i miratuar nga shteti anëtar i origjinës dhe çdo shtesë e tij është i vlefshëm për ofertën publike apo për pranim për tregtim në disa shtete anëtare pritëse, me kusht që autoriteti kompetent i çdo shteti anëtar pritës të njoftohet në përputhje me nenin 18. Autoritetet kompetente të shteteve anëtare pritëse nuk ndërmarrin procedura miratimi apo administrative në lidhje me prospektet.

2. Nëse ka faktorë të rinj domethënës, gabimet material apo pasaktësitë, sipas nenit 16, që kanë lindur që nga miratimi i prospektit, autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës kërkon publikimin e një shtese që do të miratohet sipas nenit 13, paragrafi 1. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar pritës mund të tërheq vëmendjen e autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës për nevojën për informacione të reja.

Neni 18

Njoftimi

1. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës, me kërkesë të emetuesit apo personit përgjegjës për hartimin e prospektit dhe brenda tre ditëve pune nga paraqitja e kërkesës, nëse kërkesa paraqitet bashkë me projekt-prospektin, brenda një dite pune pas miratimit të prospektit, i jep autoritetit kompetent të shtetit anëtar pritës një certifikatë miratimi që vërteton se prospekti është hartuar në përputhje me këtë direktivë dhe një kopje të prospektit në fjalë. Kur është rasti, ky njoftim shoqërohet me një përkthim të përmbledhjes të hartuar nën përgjegjësinë e emetuesit apo personit përgjegjës për hartimin e prospektit. E njëjta procedurë ndiqet për çdo shtesë të prospektit.

2. Zbatimi i dispozitave të nenit 8, paragrafi 2 dhe 3, bashkë me arsyetimin për zbatimin e tyre, duhet të citohen në certifikatë.

KAPITULLI V

PËRDORIMI I GJUHËVE DHE EMETUESIT E THEMELUAR NË VENDE TË TRETA

Neni 19

Përdorimi i gjuhëve

1. Kur bëhet një ofertë për publikun apo kur kërkohet pranim për tregtim në një treg të rregulluar vetëm në shtetin anëtar të origjinës, prospekti duhet të hartohet në një gjuhë të pranuar nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës.

2. Kur bëhet një ofertë për publikun apo kur kërkohet pranim për tregtim në një treg të rregulluar në një ose më shumë shtete anëtare përveç shtetit anëtar të origjinës, sipas rastit, prospekti hartohet në një gjuhë të pranuar nga autoriteti kompetent i atyre shteteve anëtare ose në një gjuhë të zakonshme në sferën e financave ndërkombëtare, sipas zgjedhjes së emetuesit, ofertuesit apo personit që kërkon pranim. Autoriteti kompetent i çdo shteti anëtar pritës mund të kërkojë vetëm që përmbledhja të përkthehet në gjuhën/gjuhët e tij zyrtare.

Me qëllim shqyrtimin nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës, sipas rastit, prospekti hartohet ose në një gjuhë të pranuar nga ky autoritet ose në gjuhën e zakonshme në sferën e financave ndërkombëtare, sipas zgjedhjes së emetuesit, ofertuesit apo personit që kërkon pranim për tregtim.

3. Kur bëhet një ofertë për publikun apo kur kërkohet pranim për tregtim në një treg të rregulluar në më shumë se një shtet anëtar, duke përfshirë shtetin snëtar të origjinës, sipas rastit, prospekti hartohet në një gjuhë të pranuar nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës dhe mundësohet ose në një gjuhë të pranuar nga autoritetet kompetente të çdo shteti anëtar pritës ose në gjuhën e zakonshme në sferën e financave ndërkombëtare, sipas zgjedhjes së emetuesit, ofertuesit apo personit që kërkon pranim. Autoriteti kompetent i çdo shteti anëtar pritës mund të kërkojë vetëm që përmbledhja të përkthehet në gjuhën/gjuhët e tij zyrtare, sipas nenit 5, paragrafi 2.

4. Kur kërkohet pranim për tregtim në një treg të rregulluar për tituj të tjerë, prerja për njësi e të cilëve është të paktën 50 000 euro, në një ose më shumë shtete anëtare, prospekti hartohet në një gjuhë të pranuar nga autoriteti kompetent i shteteve anëtare pritëse dhe të origjinës ose në një gjuhë të zakonshme në sferën e financave ndërkombëtare, sipas zgjedhjes së emetuesit, ofertuesit apo personit që kërkon pranim për tregtim. Shtetet anëtare mund të zgjedhin të kërkojnë në legjislacionin e tyre të brendshëm, që përmbledhja të hartohet në gjuhën/gjuhët e tyre zyrtare.

Neni 20

Emetuesit e themeluar në vende të treta

1. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës së emetuesit që e ka selinë në një vend të tretë mund të miratojë një prospekt për një ofertë publike ose për pranim për tregtim në një treg të rregulluar, të hartuar në përputhje me legjislacionin e një vendi të tretë, me kusht që:

(a) prospekti të jetë hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të vendosura nga organizata ndërkombëtare të komisioneve të letrave me vlerë, duke përfshirë standardet e nxjerrjes së informacionit të IOSCO;

(b) kërkesat për informacion, duke përfshirë informacionin e një natyre financiare, të jenë të barasvlershme me kërkesat sipas kësaj direktive.

2. Në rastin e një oferte publike apo pranimit për tregtim në një treg të rregulluar të titujve, të emetuara nga një emetues i vendosur në një vend të tretë, në një shtet anëtar që nuk është shteti anëtar i origjinës, zbatohen kërkesat e përcaktuara në nenet 17, 18 dhe 19.

3. Për të siguruar zbatimin uniform të kësaj Drektive, Komisioni miraton masat zbatuese në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 24, paragrafi 2, që deklaron se një vend i tretë siguron njëvlershmërinë e prospekteve të hartuara në atë vend, në përputhje me këtë direktivë, për shkak të legjislacionit të tij të brendshëm ose të praktikave apo procedurave të bazuara në standardet

ndërkombëtare të vendosura nga organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë edhe standardet e nxjerrjes së informacionit të IOSCO-së.

KAPITULLI VI

AUTORITETET KOMPETENTE

Neni 21

Kompetencat

1. Çdo shtet anëtar cakton një autoritet administrativ qendror kompetent, përgjegjës për kryerjen e detyrimeve sipas kësaj direktive dhe për t'u siguruar që zbatohen dispozitat e miratuara sipas kësaj direktive.

Megjithatë, një shtet anëtar, nëse kërkohet nga legjislacioni i brendshëm, mund të caktojë autoritete të tjera administrative për zbatimin e Kreut III.

Këto autoritete kompetente janë plotësisht të pavarura nga të gjithë pjesëmarrësit në treg.

Nëse bëhet publike një ofertë për tituj apo nëse kërkohet pranim për tregtim në një treg të rregulluar në një shtet anëtar, që nuk është shteti anëtar i origjinës, të drejtën për të miratuar propsekte e kanë vetëm autoritetet kompetente administrative qendrore të caktuara nga çdo shtet anëtar.

2. Shtetet anëtare mund t'u lejojnë autoriteteve të tyre kompetente të delegojnë detyrat. Përveç delegimit të publikimit në internet të prospekteve të miratuara dhe depozitimit të prospekteve sipas nenit 14, do të rishikohet çdo delegim detyrash në lidhje me detyrimet sipas kësaj direktive dhe masave zbatuese të saj, në përputhje me nenin 31, duke filluar nga 31 Dhjetori 2008 dhe deri më 31 Dhjetor 2011. Çdo delegim detyrash në subjekte të tjera, përveç autoriteteve të përmendura në paragrafin 1, bëhet në mënyrë specifike duke deklaruar detyrat që do të ndërmerren dhe kushtet sipas të cilave duhet të realizohen ato.

Këto kushte përfshijnë një klauzolë që detyron subjektin në fjalë të veprojë dhe të organizohet në mënyrë të tillë që të shmangë konfliktet e interesit dhe që informacioni i marrë gjatë ushtrimit të detyrave të deleguara të mos përdoret padrejtësisht apo për të penguar konkurrencën. Në çdo rast, përgjegjësia përfundimtare për të mbikëqyrur përputhshmërinë me këtë direktivë dhe me masat e saj zbatuese dhe për miratimin e prospektit i takon autoritetit/autoriteteve kompetente të caktuara sipas paragrafit 1.

Shtetet anëtare informojnë Komisionin dhe autoritetet kompetente të shteteve të tjera anëtare për çdo marrëveshje të bërë në lidhje me delegimin e detyrave, përfshirë edhe kushtet precize që rregullojnë këtë delegim.

3. Çdo autoritet kompetent gëzon të gjitha kompetencat e nevojshme për kryerjen e funksioneve të tij. Një autoritet kompetent që merr një aplikim për miratimin e një prospekti, ka të paktën kompetencën për:

(a) t'u kërkuar emetuesve, ofertuesve apo personave që kërkojnë pranim për tregtim në një treg të rregulluar, të përfshijnë informacion shtesë në prospekt, nëse është e nevojshme për mbrojtjen e investitorit;

(b) t'u kërkuar emetuesve, ofertuesve apo personave që kërkojnë pranim për tregtim në një treg të rregulluar dhe personave që i kontrollojnë apo kontrollohen nga ta, të japin informacione dhe dokumente;

(c) t'u kërkuar audituesve dhe drejtuesve të emetuesve, ofertuesve apo personave që kërkojnë pranim për tregtim në një treg të rregulluar, si dhe ndërmjetësve financiar të ngarkuar për bërjen e ofertave publike apo për të kërkuar pranimin për tregtim, që të japin informacion;

(d) të pezulluar një ofertë publike apo pranimin për tregtim për jo më shumë se 10 ditë pune të njëpasnjëshme për çdo rast, nëse ka baza të arsyeshme për të dyshuar se janë shkelur dispozitat e kësaj direktive;

(e) të ndaluar ose pezulluar reklamat për jo më shumë se 10 ditë pune të njëpasnjëshme për çdo rast, nëse ka baza të arsyeshme për të besuar se janë shkelur dispozitat e kësaj direktive;

(f) të ndaluar një ofertë publike, nëse zbulon se janë shkelur dispozitat e kësaj direktive ose nëse ka baza të arsyeshme për të dyshuar se janë shkelur këto dispozita;

(g) të pezulluar ose për t'u kërkuar tregjeve përkatëse të rregulluara të pezullojnë tregtimin në një treg të rregulluar për jo më shumë se 10 ditë pune të njëpasnjëshme, për çdo rast, nëse ka baza të arsyeshme për të besuar se janë shkelur dispozitat e kësaj direktive;

(h) të ndaluar tregtimin në një treg të rregulluar nëse zbulon se janë shkelur dispozitat e kësaj direktive;

(i) të bërë publik faktin se një emetues nuk po përmbush detyrimet e tij.

Kur është e nevojshme, sipas legjislacionit të brendshëm, autoriteti kompetent i kërkon autoritetit gjyqësor përkatës për të vendosur mbi përdorimin e kompetencave të përmendura në gërmat (d) deri në (h), si më sipër.

4. Gjithashtu, në momentin që titujt pranohen për tregtim në një treg të rregulluar, çdo autoritet kompetent gëzon kompetencën:

(a) t'i kërkojë emetuesit të japë të gjithë informacionin material që mund të ndikojë në vlerësimin e titujve të pranuar për tregtim në tregje të rregulluara, për të siguruar mbrojtjen e investitorit apo funksionimin normal të tregut;

(b) të pezullojë ose t'i kërkojë tregut përkatës të rregulluar të pezullojë së tregtuari tituj nëse, sipas mendimit të tij, gjendja e emetuesit është e tillë që do të dëmtonte interesat e investitorëve;

(c) të sigurojë që emetuesit, titujt e të cilëve tregtohen në tregje të rregulluara, përmbushin detyrimet e parashikuara në nenet 102 dhe 103 të Direktivës 2001/34/KE dhe që investitorëve t'u jepet informacion në mënyrë të barabartë dhe që emetuesi të trajtojë në mënyrë të barabartë të gjithë mbajtësit e titujve që kanë të njëjtin pozicion, në të gjitha shtetet anëtare ku është bërë oferta publike ose ku titujt janë pranuar për tregtim;

(d) të kryejë inspektime në terren në territorin e tij, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, për të vërtetuar përputhshmërinë me dispozitat e kësaj direktive dhe masat e saj zbatuese. Kur duhet, sipas

legjislacionit të brendshëm, autoriteti/autoritetet kompetente mund ta përdorin këtë kompetencë duke iu drejtuar autoritetit gjyqësor përkatës dhe/ose në bashkëpunim me autoritete të tjera.

5. Paragrafët 1 deri në 4 nuk cenojnë mundësinë që një shtet anëtar të marrë masa të veçanta ligjore dhe administrative për territoret jashtë shteteve evropiane, për të cilat ai shtet anëtar ka përgjegjësinë e marrëdhënieve të jashtme.

Neni 22

Sekreti profesional dhe bashkëpunimi mes autoriteteve

1. Detyrimi i sekretit profesional zbatohet për të gjithë personat që punojnë ose kanë punuar për autoritetin kompetent dhe për subjekte, të cilave autoritetet kompetente mund t'u kenë deleguar detyra të caktuara. Informacioni i mbuluar nga sekreti profesional nuk mund t'i jepet asnjë personi ose autoriteti tjetër, përveçse në përputhje me dispozitat e përcaktuara me ligj.

2. Autoritetet kompetente të shteteve anëtare duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin sa herë të jetë e nevojshme me qëllim kryerjen e detyrave të tyre dhe ushtrimin e kompetencave të tyre. Autoritetet kompetente u ofrojnë ndihmën e tyre autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare. Në veçanti, ata shkëmbejnë informacion dhe bashkëpunojnë kur një emetues ka më shumë se një autoritet kompetent të origjinës, për shkak të klasave të ndryshme të titujve ose kur miratimi i një prospekti është transferuar tek autoriteti kompetent i një shteti tjetër anëtar, në pajtim me nenin 13, paragrafi 5. Gjithashtu, ata bashkëpunojnë ngushtë kur kërkojnë pezullimin ose ndalimin e tregtimit të titujve të tregtuar në shtete anëtare të ndryshme, në mënyrë që të sigurohen kushte të barabarta mes vendeve që tregtojnë dhe mbrojtje e investitorëve. Sipas rastit, autoriteti kompetent i shtetit anëtar pritës mund të kërkojë ndihmën e autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës që nga faza kur çështja është shqyrtuar, veçanërisht, sa i përket një lloji të ri apo forme të rrallë titujsh. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës mund të kërkojë informacion nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar pritës për të gjitha njësitë specifike për tregun përkatës.

Pa cenuar nenin 21, autoritetet kompetente të shteteve anëtare mund të këshillohet me operatorët e tregjeve të rregulluara, kur është e nevojshme dhe, veçanërisht, kur vendosin të pezullojnë, ose t'i kërkojnë një tregu të rregulluar të pezullojë ose ndalojë tregtinë.

3. Paragrafi 1 nuk i ndalon autoritetet kompetente të shkëmbejnë informacion konfidencial. Në këtë rast, informacioni i shkëmbyer mbulohet nga detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional, të cilit i nënshtrohen punëmarrësit ose ish-punëmarrësit e autoriteteve kompetente që marrin informacionin.

Neni 23

Masa paraprake

1. Kur autoriteti kompetent i shtetit anëtar pritës konstaton se ka parregullsi nga ana e emetuesit apo nga institucionet financiare përgjegjëse për ofertën publike apo që janë kryer shkelje të detyrimeve që i lindin emetuesit si pasojë e pranimit të titujve për tregtim në një treg të rregulluar, ai ia raporton këto gjetje autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës.

2. Nëse, pavarësisht masave të marra nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës apo kur këto masa kanë rezultuar të pamjaftueshme, emetuesi ose institucioni financiar përgjegjës për ofertën publike vazhdon të shkelë dispozitat ligjore ose rregullatore përkatëse, autoriteti kompetent i shtet

anëtar pritës, pasi të ketë informuar autoritetin kompetent të shtetit anëtar të origjinës, merr të gjitha masat e duhura për të mbrojtur investitorët. Këto masa i komunikohen Komisionit, sa më shpejt të jetë e mundur.

KAPITULLI VII

MASAT ZBATUESE

Neni 24

Procedura e Komitetit

1. Komisioni ndihmohet nga Komiteti Evropian i Titujve, i krijuar me Vendimin 2001/528/KE (në vijim referuar si "Komiteti").

2. Në rastet kur referohet ky paragraf, zbatohen nenet 5 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij dhe me kusht që masat zbatuese që miratohen në përputhje me këtë procedurë të mos ndryshojnë dispozitat thelbësore të kësaj direktive.

Periudha e përcaktuar në nenin 5 paragrafi 6 të Vendimit 1999/468/KE është tre muaj.

3. Komiteti miraton vetë rregulloren e tij të brendshme.

4. Pa cenuar masat zbatuese të miratuara më parë, me përfundimin e periudhës prej katër vjetësh pas hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, pezullohet zbatimi i dispozitave që kërkojnë miratimin e normave teknike dhe vendimeve, në përputhje me procedurat e përmendura në paragrafin 2. Me propozim të Komisionit, Parlamenti Evropian dhe Këshilli mund të ripërtërijnë dispozitat në fjalë, sipas procedurës së parashikuar në nenin 251 të Traktatit dhe në këtë rast, ato procedojnë me këtë rishikim përpara përfundimit të periudhës katër vjeçare.

Neni 25

Sanksionet

1. Pa cenuar të drejtën e shteteve anëtare për vendosjen e sanksioneve penale, si dhe pa cenuar regjimin e tyre të përgjegjësisë civile, shtetet anëtare sigurojnë, sipas legjislacionit të tyre të brendshëm, që të merren masat apo sanksionet e duhura administrative ndaj personave përgjegjës, kur nuk veprohet në përputhje me dispozitat e miratuara në zbatimin e kësaj direktive. Shtetet anëtare sigurohen që këto masa të jenë efikase, proporcionale dhe shtrënguese.

2. Shtetet anëtare i lejojnë autoritetet kompetente që të bëjnë publike çdo masë ose sanksion që do të vendoset për shkeljen e dispozitave të miratuara në zbatimin e kësaj direktive, me përjashtim të rasteve kur bërja publike e tyre mund të rrezikojë seriozisht tregjet financiare ose të dëmtojë në mënyrë jo proporcionale palët e përfshira.

Neni 26

E drejta e ankimit në gjykatë

Shtetet anëtare sigurohen që vendimet e marra sipas ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të miratuara në përputhje me këtë direktivë, t'i nënshtrohen të drejtës së ankimit në gjykatë.

KAPITULLI VIII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 27

Ndryshimet

Direktiva 2001/34/KEE ndryshohet si më poshtë, me efekt që nga data e përcaktuar në nenin 29:

1. Nenet 3, 20 deri 41, 98 deri 101, 104 dhe 108, paragrafi 2, germa (c), pika (ii) hiqen;
2. në nenin 107, paragrafi 3, hiqet nënparagrafi i parë;
3. në nenin 108, paragrafi 2, germa (a), fjalët "kushtet e themelimit, kontrolli dhe qarkullimi i të dhënave të listimit që publikohen për pranimin" hiqen;
4. Shtojca I hiqet.

Neni 28

Shfuqizimi

Direktiva 89/298/KEE shfuqizohet me efekt që nga data e përcaktuar në nenin 29. Referimet në direktivën e shfuqizuar interpretohen si referime në këtë direktivë.

Neni 29

Transpozimi

Deri më 1 Korrik 2005, shtetet anëtare do të miratojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me këtë direktivë. Ato njoftojnë menjëherë Komisionin për këtë. Shtetet anëtare, në miratimin e këtyre masave, i referohen direktivës ose i shoqërojnë ato me një referencë në rastin e botimit zyrtar të tyre. Mënyra për bërjen e një reference të tillë përcaktohet nga vetë shtetet anëtare.

Neni 30

Dispozitë kalimtare

1. Emetuesit e themeluar në një vend të tretë, titujt e të cilëve janë pranuar më parë për tregtim në një treg të rregulluar, zgjedhin autoritetin e tyre kompetent sipas nenit 2, paragrafi 1, germa (m), pika (iii) dhe ia njoftojnë vendimin e tyre autoritetit kompetent të shtetit anëtar të origjinës të zgjedhur prej tyre, deri më 31 Dhjetor 2005.
2. Duke deroguar nga neni 3, shtetet anëtare që kanë përdorur përjashtimin në nenin 5, germa (a) të Direktivës 89/298/KEE mund të vazhdojnë t'u lejojnë institucioneve kredituese apo institucioneve të

tjera financiare të njëjta me institucionet kredituese, të cilat nuk mbulohen nga neni 1, paragrafi 2, germa (j) e kësaj Direktive, të ofrojnë tituj borxhi apo tituj të tjerë të transferueshëm të barasvlershëm me titujt e borxhit të emetuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur brenda territoreve të tyre, për pesë vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj direktive.

3. Duke deroguar nga eni 29, Republika Federale e Gjermanisë duhet të respektojë nenin 21, paragrafi 1, deri më 31 Dhjetor 2008.

Neni 31

Shqyrtimi

Pesë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj direktive, komisioni bën një vlerësim të zbatimit të kësaj direktive dhe i dorëzon një raport Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të shoqëruar, sipas rastit, me propozime për këtë rishikim.

Neni 32

Hyrja në fuqi

Kjo direktivë hyn në fuqi në datën e botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 33

Marrësit

Kjo direktivë u drejtohet shteteve anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 4 Nëntor 2003.

Për Parlamentin Evropian

Presidenti

P. Cox

Për Këshillin

Presidenti

G. Alemanno

(1) *Gazeta Zyrtare C 240 E*, 28.8.2001, f. 272 dhe *Gazeta Zyrtare C 20 E*, 28.1.2003, f. 122.

(2) *Gazeta Zyrtare C 80*, 3.4.2002, f. 52.

(3) *Gazeta Zyrtare C 344*, 6.12.2001, f. 4.

(4) Opinioni i Parlamentit Evropian i 14 Marsit 2002 (*Gazeta Zyrtare C 47 E*, 27.2.2003, f. 417), Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit i 24 marsit 2003 (*Gazeta Zyrtare C 125 E*, 27.5.2003, f. 21) dhe Qëndrimi i Parlamentit Evropian i 2 Korrikut 2003 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare). Vendim i Këshillit i 15 korrikut 2003.

(5) *Gazeta Zyrtare L 100*, 17.4.1980, f. 1. Direktiva e ndryshuar së fundmi me Direktivën 94/18/KE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (*Gazeta Zyrtare L 135*, 31.5.1994, f. 1).

(6) *Gazeta Zyrtare L 124*, 5.5.1989, f. 8.

(7) *Gazeta Zyrtare L 184*, 6.7.2001, f. 1.

- (8) *Gazeta Zyrtare L 141, 11.6.1993, f. 27.* Direktiva e ndryshuar së fundmi me Direktivën 2000/64/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (*Gazeta Zyrtare L 290, 17.11.2000, f. 27*).
- (9) Standardet ndërkombëtare të dhënies së informacionit për oferta ndërkufitare dhe listime fillestare nga emetues të huaj, Pjesa I, Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë, Shtator 1998.
- (10) *Gazeta Zyrtare L 191, 13.7.2001, f. 45.*
- (11) *Gazeta Zyrtare L 184, 17.7.1999, f. 23.*
- (12) *Gazeta Zyrtare L 135, 31.5.1994, f. 5.*
- (13) *Gazeta Zyrtare L 126, 26.5.2000, f. 1.* Direktiva e ndryshuar së fundmi nga Direktiva 2000/28/KEE (*Gazeta Zyrtare L 275, 27.10.2000, f. 37*).
- (14) *Gazeta Zyrtare L 125, 5.5.2001, f. 15.*
- (15) *Gazeta Zyrtare L 243, 11.9.2002, f. 1.*

SHTOJCA I PROSPEKTI

I. Përmbledhja

Përmbledhja jep, në pak faqe, informacionin më të rëndësishëm të përfshirë në prospekt, duke mbuluar të paktën çështjet e mëposhtme:

A. identitetin e drejtorëve, menaxherëve të lartë, këshilltarëve dhe audituesve

B. statistikat mbi ofertën dhe afatet kohore të pritshme

C. informacionin kyç lidhur me të dhënat financiare të përzgjedhura; kapitalizimi dhe borxhi; arsyet e ofertës dhe përdorimi i të ardhurave; faktorët e riskut

D. informacion në lidhje me emetuesin

- historiku dhe zhvillimi i emetuesit

- përmbledhje e veprimtarisë tregtare

E. analiza dhe perspektivat operacionale dhe financiare

- kërkimi dhe zhvillimi, patentat dhe licencat, etj.

- tendencat

F. drejtorët, menaxherët e lartë dhe punëmarrësit

G. aksionarët kryesorë dhe transaksionet e palëve të lidhura

H. informacion financiar

- pasqyrat e konsoliduara dhe informacione të tjera financiare

- ndryshime të konsiderueshme

I. Detaje të ofertës dhe pranimi për tregtim

- oferta dhe pranimi për tregtim

- plani i shpërndarjes
- tregjet
- aksionarët shitës
- rënie e vlerës (vetëm për titujt të kapitalit aksionar)
- shpenzime të emetimit
- informacione shtesë
- kapitali aksionar
- akti i themelimit dhe statuti
- dokumente të shfaqura

II. Identiteti i drejtorëve, menaxherëve të lartë, këshilltarëve dhe audituesve

Qëllimi është të identifikohen përfaqësuesit e shoqërisë dhe individë të tjerë të përfshirë në ofertën apo pranimin për tregtimin të shoqërisë; këta janë personat përgjegjës për hartimin e prospektit, sipas kërkesave të nenit 5 të direktivës, dhe personat përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare.

III. Statistika mbi ofertën dhe afatet kohore të pritshme

Qëllimi është të jepet informacion kyç në lidhje me bërjen e ndonjë oferte dhe identifikimin e datave të rëndësishme në lidhje me atë ofertë.

A. Statistika të ofertës

B. Metoda dhe afati kohor i pritshëm

IV. Informacioni kyç

Qëllimi është të jepet në mënyrë të përmbledhur informacion kyç mbi gjendjen financiare të shoqërisë, kapitalizimin dhe faktorët e riskut. Nëse pasqyrat financiare të përfshira në dokument riformulohen për të pasqyruar ndryshimet materiale në strukturën e grupit të shoqërisë apo politika kontabël, atëherë duhet të riformulohen edhe të dhënat financiare të përzgjedhura.

A. Të dhëna financiare të përzgjedhura

B. Kapitalizimi dhe borxhi

C. Arsyet e ofertës dhe përdorimi i të ardhurave

D. Faktorët e riskut

V. Informacion mbi shoqërinë

Qëllimi është të jepet informacion në lidhje me operacionet e aktivitetit të shoqërisë, produktet apo shërbimet që ofron dhe faktorët që ndikojnë në aktivitet. Gjithashtu, synon të japë informacion në

lidhje me përshtatshmërinë e pronave, impianteve dhe pajisjeve të shoqërisë, si edhe planet për rritjet apo uljen e ardhshme të kapacitetit.

- A. Historiku dhe zhvillimi i shoqërisë
- B. Përmbledhje e veprimtarisë tregtare
- C. Struktura organizative
- D. Pronat, impiantet dhe pajisjet

VI. Analiza dhe perspektivat operacionale dhe financiare

Qëllimi është të jepet shpjegimet që drejtuesit u bëjnë faktorëve që kanë ndikuar në kushtet financiare dhe rezultatet operative të shoqërisë për periudhat historike të mbuluara nga pasqyrat financiare, dhe vlerësimet që drejtuesit u bëjnë faktorëve dhe tendencave që pritet të kenë një ndikim të konsiderueshëm në kushtet financiare dhe rezultatet operative të shoqërisë për periudhat e ardhshme.

- A. Rezultatet operative
- B. Likuiditeti dhe burimet e kapitalit
- C. Kërkimi dhe zhvillimi, patentat dhe licencat, etj.
- D. Tendencat

VII. Drejtorët, menaxherët e lartë dhe punëmarrësit

Qëllimi është të jepet informacion në lidhje me drejtuesit dhe menaxherët e shoqërisë, që do t'u lejojnë investitorëve të vlerësojnë përvojën e tyre, kualifikimet dhe nivelet e pagave, si dhe lidhjet e tyre me shoqëriën.

- A. Drejtorët dhe menaxherët e lartë
- B. Paga
- C. Praktikat e bordit
- D. Punëmarrësit
- E. Zotërimi i aksioneve

VIII. Aksionarët e shumicës dhe transaksionet me palët e lidhura

Qëllimi është të jepet informacion në lidhje me aksionarët e shumicës dhe aksionarë të tjerë që mund të kontrollojnë ose kanë ndikim në shoqëri. Gjithashtu, të jepet informacion në lidhje me transaksionet e shoqërisë me persona të lidhur me shoqërinë dhe a janë kushtet e këtyre transaksioneve drejta për shoqërinë.

- A. Aksionarët e shumicës

B. Transaksione me palë të lidhura

C. Interesat e ekspertëve dhe këshilltarëve

IX. Informacion financiar

Qëllimi është të specifikohet se cilat pasqyra financiare duhet të përfshihen në dokument, si dhe periudhat që duhen mbuluar, viti i pasqyrave financiare dhe informacione të tjera të një natyre financiare. Parimet e kontabilitetit dhe të auditimit që do të përdoren gjatë përgatitjes dhe auditimit të pasqyrave financiare, do të përcaktohen në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit.

A. Pasqyrat e konsoliduara dhe informacione të tjera financiare

B. Ndryshime të konsiderueshme

X. Detaje të ofertës dhe të pranimin për tregtim

Qëllimi është të jepet informacion në lidhje me ofertën dhe pranimin për tregtim të titujve, planin e shpërndarjes së tyre dhe çështje të lidhura me to.

A. Oferta dhe pranimi për tregtim

B. Plani i shpërndarjes

C. Tregjet

D. Mbajtësit që shesin tituj

E. Rënie e vlerës (vetëm për titujt me kapital)

F. Shpenzime të emetimit

XI. Informacione shtesë

Qëllimi është të jepet informacion, pjesa më e madhe e të cilit ka një natyrë ligjore, i cili nuk mbulohet diku tjetër në prospekt.

A. Kapitali aksionar

B. Akti i themelimit dhe statuti

C. Kontrata materiale

D. Kontrolllet e shkëmbimeve

E. Tatime

F. Dividend dhe agjentë të pagueshëm

G. Pasqyrat e ekspertëve

H. Dokumente të shfaqura

I. Informacion mbi filialet

SHTOJCA II

DOKUMENTET E REGJISTRIMIT

I. Identiteti i drejtorëve, menaxherëve të lartë, këshilltarëve dhe ekspertëve kontabël

Qëllimi është të identifikohen përfaqësuesit e shoqërisë dhe individë të tjerë të përfshirë në ofertën apo pranimin për tregtimin të shoqërisë; këta janë personat përgjegjës për hartimin e prospektit dhe personat përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare.

II. Informacion kyç për emetuesin

Qëllimi është të jepet në mënyrë të përmbledhur informacion kyç mbi gjendjen financiare të shoqërisë, kapitalizimin dhe faktorët e riskut. Nëse pasqyrat financiare të përfshira në dokument riformulohen për të pasqyruar ndryshimet materiale në strukturën e grupit të shoqërisë apo politika kontabël, atëherë duhet të riformulohen edhe të dhënat financiare të përzgjedhura.

A. Të dhëna financiare të përzgjedhura

B. Kapitalizimi dhe borxhi

C. Faktorët e riskut

III. Informacion mbi shoqërinë

Qëllimi është të jepet informacion në lidhje me operacionet e aktivitetit të shoqërisë, produktet apo shërbimet që ofron dhe faktorët që ndikojnë në aktivitet. Gjithashtu, synon të japë informacion në lidhje me përshtatshmërinë e pronave, impianteve dhe pajisjeve të shoqërisë, si edhe planet për rritjet apo uljen e ardhshme të kapacitetit.

A. Historiku dhe zhvillimi i shoqërisë

B. Përmbledhje e veprimtarisë tregtare

C. Struktura organizative

D. Pronat, impiantet dhe pajisjet

IV. Analiza dhe perspektivat operacionale dhe financiare

Qëllimi është të jepen shpjegimet që drejtuesit u bëjnë faktorëve që kanë ndikuar në kushtet financiare dhe rezultatet operative të shoqërisë për periudhat historike të mbuluara nga pasqyrat financiare, dhe vlerësimet që drejtuesit u bëjnë faktorëve dhe tendencave që pritet të kenë një ndikim të konsiderueshëm në kushtet financiare dhe rezultatet operative të shoqërisë për periudhat e ardhshme.

A. Rezultatet operative

B. Likuiditeti dhe burimet e kapitalit

C. Kërkimi dhe zhvillimi, patentat dhe licencat, etj.

D. Tendencat

V. Drejtorët, menaxherët e lartë dhe punonjësit

Qëllimi është të jepet informacion në lidhje me drejtuesit dhe menaxherët e shoqërisë, që do t'u lejojnë investitorëve të vlerësojnë përvojën e tyre, kualifikimet dhe nivelet e pagave, si dhe lidhjet e tyre me shoqërinë.

A. Drejtorët dhe menaxherët e lartë

B. Paga

C. Praktikat e bordit

D. Punëmarrësit

E. Zotërimi i aksioneve

VI. Aksionarët e shumicës dhe transaksionet me palët e lidhura

Qëllimi është të jepet informacion në lidhje me aksionarët e shumicës dhe aksionarë të tjerë që mund të kontrollojnë ose kanë ndikim në shoqëri. Gjithashtu, të jepet informacion në lidhje me transaksionet e shoqërisë me persona të lidhur me shoqërinë dhe a janë kushtet e këtyre transaksioneve të drejta për shoqërinë.

A. Aksionarët e shumicës

B. Transaksione me palë të lidhura

C. Interesat e ekspertëve dhe këshilltarëve

VII. Informacion financiar

Qëllimi është të specifikohet se cilat pasqyra financiare duhet të përfshihen në dokument, si dhe periudhat që duhen mbuluar, viti i pasqyrave financiare dhe informacione të tjera të një natyre financiare. Parimet e kontabilitetit dhe të auditimit që do të përdoren gjatë përgatitjes dhe auditimit të pasqyrave financiare, do të përcaktohen në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit.

A. Pasqyrat e konsoliduara dhe informacione të tjera financiare

B. Ndryshime të konsiderueshme

VIII. Informacione shtesë

Qëllimi është të jepet informacion, pjesa më e madhe e të cilit ka një natyrë ligjore, i cili nuk mbulohet diku tjetër në prospekt.

- A. Kapitali aksionar
- B. Akti i themelimit dhe statuti
- C. Kontrata materiale
- D. Pasqyrat e ekspertëve
- E. Dokumente të shfaqura
- F. Informacion mbi filialet

SHTOJCA III

SHËNIME PËR TITUJT

I. Identiteti i drejtorëve, menaxherëve të lartë, këshilltarëve dhe ekspertëve kontabël

Qëllimi është të identifikohen përfaqësuesit e shoqërisë dhe individë të tjerë të përfshirë në ofertën apo pranimin për tregtimin të shoqërisë; këta janë personat përgjegjës për hartimin e prospektit dhe personat përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare.

II. Statistika mbi ofertën dhe afatet kohore të pritshme

Qëllimi është të jepet informacion kyç në lidhje me bërjen e ndonjë oferte dhe identifikimin e datave të rëndësishme në lidhje me atë ofertë.

- A. Statistika të ofertës
- B. Metoda dhe afati kohor i pritshëm

III. Informacion kyç për emetuesin

Qëllimi është të jepet në mënyrë të përmbledhur informacion kyç mbi gjendjen financiare të shoqërisë, kapitalizimin dhe faktorët e riskut. Nëse pasqyrat financiare të përfshira në dokument riformulohen për të pasqyruar ndryshimet materiale në strukturën e grupit të shoqërisë apo politika kontabël, atëherë duhet të riformulohen edhe të dhënat financiare të përzgjedhura.

- A. Kapitalizimi dhe borxhi
- B. Arsyet e ofertës dhe përdorimi i produkteve
- C. Faktorët e riskut

IV. Interesat e ekspertëve

Qëllimi është të mundësohet informacion në lidhje me transaksione që shoqëria ka kryer me ekspertë apo këshilltarë të punësuar sipas rastit.

V. Detaje të ofertës dhe pranimi për tregtim

Qëllimi është të jepet informacion në lidhje me ofertën dhe pranimin për tregtim të titujve, planin e shpërndarjes së tyre dhe çështje të lidhura me to.

- A. Oferta dhe pranimi për tregtim
- B. Plani i shpërndarjes
- C. Tregjet
- D. Mbajtësit e titujve për shitje
- E. Rënie e vlerës (vetëm për titujt të kapitalit aksionar)
- F. Shpenzime të emetimit

VI. Informacione shtesë

Qëllimi është të jepet informacion, pjesa më e madhe e të cilit ka një natyrë ligjore, i cili nuk mbulohet diku tjetër në prospekt.

- A. Kontrollat e shkëmbimit
- B. Tatime
- C. Dividendi dhe agjentë të pagueshëm
- D. Pasqyrat e ekspertëve
- E. Dokumente të shfaqura

SHTOJCA IV

SHËNIM PËRMBLEDHËS

Shënimi përmbledhës jep, në pak faqe, informacionin më të rëndësishëm të përfshirë në prospekt, duke mbuluar të paktën çështjet e mëposhtme:

- identiteti i drejtorëve, menaxherëve të lartë, këshilltarëve dhe ekspertëve kontabël
- statistika mbi ofertën dhe afatet kohore të pritshme
- informacion kyç lidhur me të dhënat financiare të përzgjedhura; kapitalizimi dhe borxhi; arsyet e ofertës dhe përdorimi i të ardhurave; faktorët e riskut
- informacion për emetuesin
- historiku dhe zhvillimi i emetuesit
- përmbledhje e veprimtarisë tregtare
- analiza dhe perspektivat operacionale dhe financiare

- kërkimi dhe zhvillimi, patentat dhe licencat, etj.
- tendencat
- drejtorët, menaxherët e lartë dhe punonjësit
- aksionarët e shumicës dhe transaksionet me palët e lidhura
- informacion financiar
- pasqyrat e konsoliduara dhe informacione të tjera financiare
- ndryshime të konsiderueshme
- detaje të ofertës dhe pranimi për tregtim
- oferta dhe pranimi për tregtim
- plani i shpërndarjes
- tregjet
- aksionarët shitës
- rënie e vlerës (vetëm për titujt të kapitalit aksionar)
- shpenzime të emetimit
- informacione shtesë
- kapitali aksionar
- akti i themelimit dhe statuti
- dokumente të disponueshme për inspektim